

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5655
E hënë, 17 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

Thaçi: Ushtria e Kosovës është proces i pakthyeshëm



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE




DRITA E AMERIKËS NË KOSOVË F. 14

Ismet SYLEJMANI

JETËSIMI I USHTRISË, AKT I SENDËRTIMIT TË PLOTË TË SHTETFORMIMIT TË KOSOVËS

F. 12

Arbër HADRI



JASHAR SALIHU, HERO I VEÇANTË I KOSOVËS F. 11

Lulëzim ETEMAJ

LARGOHEN 803 DEPONI ILEGALE MBETURINASH F. 7

EKONOMI

BIEN EKSPORTET E KOSOVËS NË SERBI F. 9

AZHB-JA: MAKINERIA BUJQËSORE PA NUMËR SERIK NUK DO TË RIMBURËSOHET F. 9

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI | FAQE 7

Aprovimi i rezolutës fuqizon Kosovën në dialogun me Serbinë

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka vlerësuar se miratimi i rezolutës dhe mandatimi i ekipit negociator për bisedimet me Serbinë, përveçse tejkalon ngërçin politik, fuqizon edhe pozitën e Kosovës në procesin e

dialogut. Ai ka thënë se tani dialogu do të jetë më transparent, i kontrollueshëm dhe fundi i tij do të vulozet nga Kuvendi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka theksuar se me inkuadrimin në dialog

PSD-ja ka ndërmarrë hapin e guximshëm për të dalë nga hija e Vetëvendosjes. Kurse sa i përket mospërfshirjes së LDK-së dhe Vetëvendosjes në proces, ai ka thënë se këto dy parti nuk i kanë vlerësuar drejt prioritetet

ZYRTARËT E BASHKIMIT EVROPIAN (BE) I SHKRUAJNË LETËR KRYEMINISTRIT RAMUSH HARADINAJ RRETH TAKSËS SË VENDOSUR NDAJ PRODUKTEVE TË SERBISË DHE BOSNJËS

BE-ja ofron kompromis për taksën, Kosova nuk ndryshon qëndrim



Edhe 25 shtëpi të reja për skamnorët do të ndërtohen në Skenderaj

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Protesta në Beograd, kërkohet dorëheqja e Vuçiqit

Me pankarta me thirrje të ndryshme si "Deri kur do të vazhdojë Serbia të jetë e keqja", mijëra protestues në Beograd, të cilëve u prinin ish-ministri serb Vuk Jeremiç dhe kryetari i Beogradit, Dragan Gjilas, kanë kërkuar dorëheqjen e presidentit Aleksandar Vuçiq



BEOGRAD, 16 DHJETOR - Liderët opozitarë në Serbi janë zotuar për t'i vazhduar protestat në janar pas marshit të mijëra personave në Beograd në kundërshtim të qeverisjes së presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq.

Me pankarta me thirrje të ndryshme si "Deri kur do të vazhdojë Serbia të jetë e keqja", protestuesit kërkuar dorëheqjen e presidentit Vuçiq.

Organizatorët thanë se protestat e ardhshme pritet të mbahen më 16 janar, në përvjetorin e vdekjes së politikanit serb në Kosovë, Oliver Ivanović, vrasja e të cilit nxitit tensione në të dy vendet.

Ivanović u qëllua për vdekje para zyrës së tij në Mitrovicë.

"Ne nuk do të ndalemi apo të heshtim", tha lideri i Partisë majtiste Borko

Stefanović, që ishte sulmuar muajin e kaluar në Krushevc nga disa persona.

Ish-ministri serb Vuk Jeremiç dhe kryetari i Beogradit,

Dragan Gjilas, ishin në krye të protestës më 15 dhjetor.

Demonstruesit fishkëllenin me bilbila, bori dhe brohorinin kundër presidentit dhe qeverisë, që të kujtonte kohën e protestave të viteve 90-të, kur në krye të kolonave protestuese ishin ish-kryeministri Zoran Djindjic dhe lideri i opozitës Vuk Drasković. Protestat kanë rezultuar në tetor të vitit 2000 me largimin e Slobodan Millosheviçit nga pushteti, dërgimin e tij në Hagë, ku akuzohej për krime lufte, ku edhe vdiq në burg.

Në Serbi aktualisht po vazhdon një tendosje e thellë për shkak të krijimit të Ushtrisë së Kosovës, respektivisht transformimit të FSK-së në ushtri. Parlamenti i Kosovës ka votuar të premtën e kaluar tri ligje për transformimin e FSK në ushtri. Kjo është pritur me reagime të ashpra në Beograd, ku thuhet se Serbia nuk do të lejojë aksionet e dhunshme ndaj serbëve në Kosovë. Presidentit Vuçiq ka kërkuar mbajtjen e

një seance të jashtëzakonshme të KS të OKB-së, sot (e hënë) në Nju Jork. Zhvillimet e fundit janë përdorur nga opozita për

të kritikuar politikën e deritanishme të qeverisë serbe dhe presidentit Vuçiq ndaj Kosovës. Në një raport të fundit në

Serbi, Parlamenti Evropian ka thënë se Serbia duhet të përmirësojë "lirinë e shtypit dhe lirinë e shprehjes".

Daçiqi: Ushtria e Kosovës nuk zhbëhet

BEOGRAD, 16 DHJETOR - Ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Daçiq ka thënë të dielën se do të jetë e vështirë për ta ndryshuar qëndrimin e fuqive të mëdha për formimin e Ushtrisë së Kosovës.

Megjithatë e konsideron të rëndësishme mbajtjen e seancës së Këshillit të Sigurimit

të Kombeve të Bashkuara, ku siç thotë ai, ato do të dëgjojnë se "kjo është një shkelje e rezolutës 1244, i vetmi dokument i vlefshëm për Kosovën". "Është e rëndësishme që në seancën e Këshillit të Sigurimit të përcillet presidenti Aleksandar Vuçiq", tha Daçiqi, duke shtuar se megjithatë nuk

pret ndonjë vendim.

"Megjithatë, është e rëndësishme të dëgjohej zëri i Serbisë dhe të dënohen këta njerëz dhe aktivitetet e Prishtinës, një dekadë pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë", tha Daçiqi, duke shtuar se pa mbështetjen ndërkombëtare Kosova nuk do të ekzistonte.

Buxheti nuk ndryshon, PS-ja do të rrëzojë dekretin e Metës

TIRANË, 16 DHJETOR - Mazhoranca pritet ta rrëzojë dekretin me të cilin presidenti Meta ktheu për rishqyrtim në Kuvend buxhetin e vitit 2019. Burime pranë socialistëve thanë se buxheti nuk ka gjasa të ndryshojë dhe dekreti presidencial pritet të rrëzohet në seancën e fundit para mbylljes së këtij sesioni parlamentar, parashikuar në kalendar për të premtën më 21 dhjetor.

Të enjten që shkoi Ilir Meta u bë presidenti i parë që ktheu një ligj për buxhetin, duke iu



referuar kërkesave të studentëve që duan rritjen e buxhetit të arsimit në 5%. Presidenti tha

se me këtë lëvizje synonte garantimin e stabilitetit në vend dhe shprehte besimin e

plotë se Kuvendi do të reflektoonte me qëllim plotësimin e kërkesave të studentëve.

Pavarësisht rrëzimit të dekretit presidencial, qeveria mund të bëjë më tej gjatë vitit të ardhshëm ndryshime në buxhet, pas dialogut që kryeministri thotë se dëshiron të zhvillojë me studentët.

Çfarë gjithashtu nuk ka gjasa të kalojë në seancën e fundit është amnistia. Projektligji ende nuk është miratuar nga Qeveria dhe rregullorja e Kuvendit nuk lejon as kalimin

me procedurë të përsheptuar, në kushtet kur kjo mundësi është zënë nga ligji për krijimin e xhandarmërisë.

Për më tepër, amnistia kërkon shumicë të cilësuar me 84 vota dhe ndonëse opozita do të kthehet në Parlament, fryma është në skajin e kundërt të dakordësisë.

E njëjta frymë pritet të sjellë edhe rrëzimin e propozimit kushtetues të demokratëve për vettingun e politikanëve, në kushtet kur as Komisioni i Venecias nuk e mbështeti atë.

Basha fton qytetarët në protestën e studentëve

TIRANË, 16 DHJETOR - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka dalë sërish të dielën në mbështetje të banorëve të zonës ku bie gjurma e projektit të "Unazë së Re", në afërsi të rrethotullimit "Shqiponja".

Basha u tha banorëve se po mos të kishin qenë ata në protesta, gjur-

mët e vjedhjes, sipas tij, të 40 milionë eurove për 2.2 kilometra rrugë do të ishin fshehur.

"Kosto e jetesës së shqiptarëve e papërbalueshme. Tek "Unaza e Re" janë realizuar dy krime, kompsioni i zyrtarëve të lartë, nga i pari i qeverisë deri tek i fundit i ARRSH-

së. Të gjithë kanë kontribuar t'u vjedhin shqiptarëve 40 milionë euro", tha Basha.

Kreu i Partisë Demokratike tha se shqiptarët duhet t'i mbështesin edhe studentët. "Sot e gjithë Shqipëria po proteston. Ne mbështesim protestat e studen-

tëve. Nembështesim kërkesat e tyre dhe Rama duhet t'i realizojë kërkesat e studentëve. PD-ja u bën thirrje të gjithë qytetarëve, prindërve të studentëve të dalin në protestë dhe të mbështesin studentët në nismën e tyre pasi kanë të drejtë në kërkesat e tyre", tha Basha.



Miratimi i rezolutës për dialog nga Kuvendi ka nxitur reagime të shumta

Dialogu, në dorë të opozitës

PSD-së, AAK-së, Nismës, Grupit 6+, AKR-së, Alternativës.

Miratton këtë:

REZOLUTË

Për finalizimin e dialogut në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy shteteve.

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës insiston që dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të përmbillet me një Marrëveshje ligjore ndërkombëtarisht obligative, përmes të së cilës do të ndodhë njohja reciproke në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm. Kufijtë e Republikës së Kosovës janë të pacenueshëm dhe të panegociushëm.

Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate, Visar Ymeri, u është kundërpërgjigjur dy liderëve opozitarë për rezolutën e dialogut të miratuar në Kuvend. Ai ka ftuar Isa Mustafën dhe Albin Kurtin, të cilët e kanë kritikuar rezolutën e PSD-së, që ta lexojnë këtë dokument dhe të binden se ky proces do të jetë në dorë të opozitës. Sipas tij, LDK-ja dhe LV-ja nuk duhet të vajojnë, por t'i bashkohen procesit

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Partia Socialdemokrate (PSD) ka reaguar ndaj akuzave të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV) për rezolutën për dialogun me Serbinë. Nënkryetari i PSD-së, Visar Ymeri, ka bërë me dije se delegacionin shtetëror të Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë do ta bashkëdrejttojë opozita (Shpend Ahmeti dhe Fatmir Limaj). Ai i ka ftuar Isa Mustafën dhe Albin Kurtin që ta lexojnë mirë rezolutën dhe ligjin për dialog dhe të shohin se të gjitha siguresat vendimmarrëse janë aty. "Brenda delegacionit vendimet do të merren me unanimitet. Kur nuk arrihet unanimiteti pas dy tentimeve, atëherë me 2/3 e anëtarëve. Raporti mes koalicionit qeveritar dhe opozitës/shoqërisë civile në delegacion është 7 me 5. Ky proces është në dorë të opozitës. Po ta lexonin rezolutën dhe ligjin, edhe Albin Kurti edhe Isa Mustafa do ta kuptonin qartë se të gjitha siguresat vendimmarrëse, procedurale dhe politike e

juridike, janë paraparë aty. Nuk ka marrëveshje pa njohje!", ka shkruar Ymeri në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka shtuar se sovraniteti shtetëror, integriteti territorial, karakteri unitar i Republikës janë të pacenueshme e të patjetërsueshme. "Në të vërtetë jemi ngritur në këmbë si Republikë, si Kosovë e si Kuvend. Të vetmit që janë shtrirë e futur nën sqetull janë ata që po vajojnë, kukuvajkat. Të struktur në rehatinë e zyrave e shtëpive të tyre që vajojnë për legjitimitetin e munguar, me një ligjërime që lëngon nga formalizmi absurd. Thua ti, atë që ata e quajnë legjitimitet garanton marrëveshje të dobishme për Kosovën. Ç'marrëveshje? Sikur ajo për Zajednicë? Pa kurrfarë përfitim për Kosovën", ka thënë Visar Ymeri.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka kundërshtuar këtë rezolutë, duke vlerësuar se ky dokument nuk është zgjidhje për dialogun, por është zgjidhje afatshkurtër për të mbetur në pushtet koalicioni i dështuar qeverisës. "Ky

nuk është vendim gjithëpërfshirës, siç dëshiron ta mashtrijë veten dhe adresën e vet ndonjë ndërkombëtar. Kosovës i nevojitet një proces i dialogut dhe marrëveshje e arritur dhe e përkrahur nga shumica e paraparë me Kushtetutë. Një marrëveshje e qëndrueshme. Çdo veprim tjetër është blerje kohe dhe mashtrim. Procesi dhe Marrëveshja eventuale për dialogun e ekipeve të improvizuara pa legjitimitet me votë të qytetarëve dhe e institucioneve pa legjitimitet kushtetues është në dëm të Kosovës dhe do të kundërshtohet fuqishëm nga LDK-ja", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe më i ashpër ndaj PSD-së ka qenë lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti. Sipas tij, pas formimit të ushtrisë PSD-ja menjëherë iu shtri pushtetit. "U shtrinë. Ende pa u bërë gjashtë orë nga miratimi i tri ligjeve të cilat e bënë Kosovën me Ministri të Mbrojtjes dhe me FSK të avancuar drejt ushtrisë, u mblodhën nënshkrimet për seancë urgjente për normalizim me Serbinë. Punësimi e drejtësia, arsimiti e shëndetësia,

buxheti i ri për FSK-në, të gjitha këto presin, ama dialogu me Serbinë është çështje urgjente, thanë mbrëmë! Kush donte ta zvogëlonte entuziazmin popullor për ushtrinë në Kosovë? Askush si Serbia. Ishte çështje urgjente kjo. Andaj shpejt u shtrinë", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas rezolutës së miratuar në Kuvend, Shpend Ahmeti nga PSD-ja dhe Fatmir Limaj do të jenë kryesues të këtij delegacioni. Ndërkaq anëtarë, sipas kësaj rezolute, do të jenë: Enver Hoxhaj nga PDK-ja, Avni Arifi nga AAK-ja, Behgjet Pacolli nga AKR-ja, Mahir Jaghillar, Dardan Gashi, dhe një përfaqësues i shoqërisë civile. Përveç kësaj, në ekip janë rezervuar dy vende për LDK-në dhe LV-në që e kanë bojkotuar këtë seancë, ndërsa Visar Ymeri dhe Dardan Sejdiu janë emrat që do t'i zëvendësojnë këta në pritje.


ShBA-ja dhe BE-ja e përshëndesin votimin e rezolutës, Serbia kundër

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) e kanë mirëpritur miratimin e rezolutës për dialog. Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Philip Kosnett, në llogarinë e vet në "Twitter" ka shkruar se është i inkurajuar për pjesëmarrjen politike të Kosovës në dialogun me Serbinë

i cili është i ndërmjetësuar nga Brukseli. "Mirëpresim votimin e së shtunës për miratimin e rezolutës për dialogun. Jemi të inkurajuar ta shohim pjesëmarrjen politike për dialog nën udhëheqjen e BE-së dhe me përkrahjen tonë për zgjidhje kreative", ka shkruar Kosnett. Kurse shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka vlerësuar se Kosova duhet të sigurohet që të ketë një qasje gjithëpërfshirëse në këtë proces. "E përgëzoj Kuvendin e Kosovës për votimin e sotëm për marrjen e përgjegjësive për një proces kaq të rëndësishëm si dialogu me Serbinë. Kosova duhet të sigurohet që të ketë një qasje gjithëpërfshirëse në këtë proces", ka shkruar Apostolova në "Twitter". Por miratimi i kësaj rezolute nuk i ka pëlqyer presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. "Që secila marrëveshje duhet të çojë drejt pavarësisë së plotë të Kosovës, se nuk ka ndryshim kufijsh, që nënkupton se Kosova duhet të njihet brenda kufijve të tanishëm, dhe se duhet të ruhet integriteti territorial i Kosovës sipas parimit unitar, që nënkupton se disa pjesë të territorit nuk mund të kenë autonomi. Përndryshe, ata po dëshirojnë që në thelb t'ia mbyllin derën çdo dialogu. Me këtë dokument ata qartë thanë 'i dëshirojmë të gjitha dhe me çdo çmim'", ka thënë presidenti serb në një intervistë për televizionin serb "prva".

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI

Aprovimi i rezolutës fuqizon Kosovën në dialogun me Serbinë



Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka vlerësuar se miratimi i rezolutës dhe mandatimi i ekipit negociator për bisedimet me Serbinë, përveçse tejkalon ngërçin politik, fuqizon edhe pozitën e Kosovës në procesin e dialogut. Ai ka thënë se tani dialogu do të jetë më transparent, i kontrollueshëm dhe finalja e tij do të vulozet nga Kuvendi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka theksuar se me inkuadrimin në dialog PSD-ja ka ndërmarrë hapin e guximshëm për të dalë nga hija e Vetëvendosjes. Kurse sa i përket mospërfshirjes së LDK-së dhe Vetëvendosjes në proces, ai ka thënë se këto dy parti nuk i kanë vlerësuar drejt prioritetet

dhe të kyçen më vonë në proces ndonëse, sipas tij, kjo nuk është shumë e besueshme. "Ata e shohin procesin të përmbysur, e kanë me nguti rilegjitimimin, me shpresën se pushteti do t'i takojë atyre, kurse dialogu mund të presë, bile edhe të riformatizohet. Sidoqoftë, tani ekipi negociator është legjitim, nuk e ka vetëm shumicën e brishtë e nxënë varur me praninë/mospraninë e Listës Serbe, kurse tani të paktën për dialog kemi shumicën solide të përfaqësimit", është shprehur Maliqi, duke shtuar se LDK-ja dhe Vetëvendosja mund të faktorizohen kur marrëveshja finale do të vijë për miratim në Kuvendin e Kosovës meqë nevojiten edhe votat e tyre.

"Epoka e re": Z. Maliqi, si e keni parë miratimin e rezolutës për dialogun dhe mandatimin e

ekipit negociator?

Maliqi: Aprovimi i rezolutës dhe inkuadrimi i PSD-së në grupin për dialog janë akte që pas disa vjetësh tejkalojnë ngërçin dhe bllokadat që e kanë shkaktuar përçarjen në dy blloqe dhe vendnumërimin e dëmshëm në vazhdimin e proceseve të shtetndërtimit të Kosovës dhe fuqizimin e pozitës dhe të qëndrimeve më konsistente të Kosovës në dialogun me Serbinë si dhe sigurimin e respektit nga BE-ja, ku çarjet tona kanë shkaktuar mosliberalizimin e regjimit të vizave. Edhe pse rezoluta si dhe krijimi i ekipit për dialog janë aprovuar vonë, thuajse në moment të fundit, shpresoj se është kapur hapi. Nëse janë të sakta parashikimet që marrëveshja obliguese mes Kosovës dhe Serbisë duhet të arrihet sa më shpejt, me gjasë brenda gjashtë muajve të

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Njohësi i proceseve politike në vend, Shkëlzen Maliqi, ka mirëpritur miratimin e rezolutës dhe ekipit negociator për dialogun Kosovë - Serbi. Ai ka thënë të dielën se ky veprim mund ta fuqizojë pozitën e shtetit të Kosovës në këtë proces. "Edhe pse rezoluta si dhe krijimi i ekipit për dialog

janë aprovuar vonë, thuajse në moment të fundit, megjithatë shpresoj se është kapur hapi", ka deklaruar Maliqi në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re". Sipas Maliqit, kryesorja është se tani i gjithë procesi premton se do të jetë më transparent, i kontrollueshëm dhe finalja e tij do të vulozet nga Kuvendi i Kosovës. Ai ka vlerësuar se PSD-ja me inkuadrimin në dialog ka ndërmarrë hapin e

guximshëm për të dalë nga hija e Vetëvendosjes, duke bërë kështu opozitë konstruktive kur janë në pyetje çështjet madhore. Ndërsa sa i përket mospërfshirjes së LDK-së dhe Vetëvendosjes në dialog, ai ka thënë se këto dy parti nuk i kanë vlerësuar drejt prioritetet se çka është për momentin urgjente dhe çka mund të presë. Megjithatë, Maliqi ka theksuar se LDK-ja dhe LV-ja mund të reflektojnë

kyçen më vonë, ndonëse kjo nuk është shumë e besueshme. Argumentet e tyre kundër nuk janë për t'u injoruar krejtësisht, sepse kërkonin që paraprakisht të bëhet reforma zgjedhore dhe të mbahen zgjedhjet e parakohshme. Por, mendoj se LDK-ja dhe LV-ja nuk i kanë vlerësuar drejt prioritetet, çka është për momentin urgjente dhe çka mund të presë. Ata e shohin procesin të përmbysur, e kanë me nguti rilegjitimimin, me shpresën se pushteti do t'u takojë atyre, kurse dialogu mund të presë, bile edhe të riformatizohet. Sidoqoftë, tani ekipi negociator është më legjitim, nuk e ka vetëm shumicën e brishtë e nxënë varur me praninë/mospraninë e Listës Serbe, kurse tani, të paktën, për dialog kemi shumicën solide të përfaqësimit.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh se tash ekipi drejtohet nga opozita, përkatësisht nga PSD-ja, cila do të jetë ecuria e procesit?

Maliqi: PSD-ja ka ndërmarrë hapin e guximshëm që e nxjerr nga hija e LV-së. Nga ana tjetër, ajo nuk është futur në Qeveri, por mbetet opozitë. Ky është qëndrimi i asaj që në politikë quhet opozitë konstruktive. Kur janë në pyetje çështjet madhore lihen anash merit dhe mospajtimet mes subjekteve politike. Po kështu, PSD-ja ka hequr dorë edhe nga kontestimi i rolit të Hashim Thaçit në dialog. Ai e ka vendin e vet në dialog në nivelin e takimeve të presidentëve, por duhet të koordinohet me ekipin negociator të sapokonstituuar. Njëfarë dore edhe presidentin duhet parë si pjesë e ekipit.

"Epoka e re": Z. Maliqi, a besoni se tashmë është gjetur formula e duhur për arritjen e qëllimit të Kosovës në kuadër të dialogut me Serbinë?

Maliqi: Kryesorja është se tani i gjithë procesi premton se do të jetë më transparent dhe i kontrollueshëm, me finalen që do të vulozet nga Kuvendi. Nëse dialogu dhe marrëveshja historike me Serbinë janë projekte premtuese, kjo do të shihet. Opozita edhe e ka kërkuar këtë tërë kohën, pra transparencën, përgjegjshmërinë dhe vijat e kuqe. Nuk ka pasur arsye që e gjithë loja të duket si tentim për frenimin ose edhe eliminimin e presidentit Thaçi. Njëfarë dore edhe opsioni i tij që kohët e fundit nuk e përmend aq shumë, mund të mbetet në lojë, por tani është me rëndësi që zgjedhja e propozuar, nëse arrihet pajtimi, duhet të ratifikohet/ aprovohet nga 2/3 e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, e kjo sërish 'faktorizon' LDK-në dhe Vetëvendosjen, sepse nevojiten edhe votat e tyre, nëse jo për afirmim, atëherë për rrëzimin e marrëveshjes.

Zyrtarët e Bashkimit Evropian (BE) i shkruajnë letër kryeministrit Ramush Haradinaj rreth taksës së vendosur ndaj produkteve të Serbisë dhe të Bosnjës

BE-ja ofron kompromis për taksën, Kosova nuk ndryshon qëndrim

Përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini, komisionarja për tregti Cecilia Malmstrom dhe komisionari Johannes Hahn, në një letër të përbashkët drejtuar kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, kanë kërkuar që të suspendohet taksa prej 100 për qindësh ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës. Ata kanë kërkuar që të suspendohet taksa e lartcekur në këmbim që emërtimi "UNMIK" në CEFTA të zëvendësohet me "Kosova*". Por shefi i stafit të kryeministrit, Avni Arifi, ka bërë me dije se Qeveria e Kosovës nuk ka ndryshuar qëndrim ndaj taksës

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pranuar një letër të përbashkët nga përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini, komisionarja për tregti Cecilia Malmstrom dhe komisionari Johannes Hahn, nëpërmjet së cilës Kosovës i ofrojnë një opsion për zgjidhjen e problemit të taksës 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë. Në vazhdim të letrës thuhet se "kjo do të mund, po ashtu, ta përfshijë edhe çështjen e gjatë të zëvendësimit të UNMIK-ut me Kosovo* dhe çështjen më të gjerë të modernizimit dhe rivitalizimit të CEFTA-s", ofrojnë nënshkruesit e kësaj letrë. Ata kërkojnë që Qeveria e Kosovës, si shenjë e vullnetit të mirë, para takimit të Këshillit MSA-së, pra këtë të hënë (më 17 dhjetor), ta sus-

pendojë përkohësisht zbatimin e vendimit për taksën përderisa të zgjasin përpjekjet për zgjidhjen e përhershme të problemit. Shefi i stafit të kryeministrit Ramush Haradinaj, Avni Arifi, ka reaguar pas propozimit që ka bërë treshja e BE-së, që të hiqet taksa 100 për qind nëse Kosova do që në CEFTA të hiqet emërtimi "UNMIK" e të zëvendësohet me "Kosova*". Ai ka treguar se Qeveria e Kosovës pothuajse për çdo ditë komunikon me Brukselin. Arifi ka thënë se Qeveria në këtë drejtim nuk ka bërë asnjë ndryshim në politikën e saj. "Qeveria e Kosovës pothuajse për çdo ditë komunikon me Brukselin në formë të ndryshme, me letra, në formë telefonike apo edhe në takime të drejtpërdrejta. Në të gjitha takimet ka letra të rëndësishme, ka dokumente të rëndësishme. Sa i përket pyetjes për letrën e Mogherinit që sot pothuajse çdo

medium ka pasur pyetje, nuk mund ta komentojmë përmbajtjen e saj e as përmbajtjen që kryeministri Haradinaj ia ka kthyer, sepse nuk besoj se i ka mbërritur zonjës Mogherini, por çka mund të konstatojë është se Qeveria e Kosovës në asnjë mënyrë nuk ka bërë asnjë ndryshim në politikën e vet, as ndaj taksës, as ndaj qëndrimeve të tjera që lidhen me statusin apo për temat aktuale për të cilat flasim", ka thënë Arifi të dielën. Edhe Halil Matoshi, i cili është këshilltar i kryeministrit Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se taksa hiqet vetëm kur Serbia ta njohë pavarësinë e Kosovës. Matoshi ka treguar se në këtë çështje me zyrtarët e lartë të BE-së nuk është gjetur një kompromis. "Në Kosovë askush nuk ka të drejtë të bëjë kompromis mbi 17 shkurtin, sovranitetin dhe tërësinë territoriale të saj", ka thënë Matoshi.



ardhshëm, rirreshtimi në skenën politike të Kosovës premton se do të jetë më dobi, shumë më mirë nëse në këtë periudhë do të mbeteshim të përcarë duke kontestuar angazhimet e presidentit Thaçi si të vetmit negociator aktiv. Tani kemi dy instanca të dialogut ekzekutiv, shpresoj të koordinuara mes vete, me garancinë se vendimmarrja finale do të ndodhë në Kuvend i cili ratifikon ose refuzon marrëveshjen.

"Epoka e re": Si e komentoni mospërfshirjen e LDK-së dhe të Lëvizjes Vetëvendosje në këtë ekip dhe a mund të ndodhë që në të ardhmen kjo parti të bëhet pjesë e procesit?

Maliqi: LDK-ja dhe LV-ja nuk pranuan të hyjnë në ekip, por i kanë ende vendet e rezervuara. Pra, mund të reflektojnë dhe të

Saktësi gjuhësore, jo lojë fjalësh



Shkruan: Jakup KRASNIQI

Pas votimit të delegacionit qeveritar në Kuvendin e Kosovës më 15 dhjetor 2018, Dardan Sejdiu paska thënë: "Hera e parë që kemi prej nisjes Kuvendin në timon të dialogut". Por, votimi i sotëm timonin për dialog nuk ia la në duar Kuvendit, se edhe ashtu nuk mund t'ia merrte diçka që e kishte ai. Nëse përdorim saktësinë gjuhësore duhet të thuhet: Timoni për dialog (bisedime) me Serbinë prej sot është në duart e delegacionit që u miratua në Kuvendin e Kosovës e jo në duart e presidentit. Kjo mund të thuhet dhe duhej të thuhet.

Pse?

Me votimin e Rezolutës së propozuar nga PSD-ja, Kuvendi nuk ka marrë asnjë kompetencë që nuk e kishte, por i ka dhënë fuqi funksionimi një Delegacioni qeveritar për të biseduar me Serbinë në Bruksel. Natyrisht, materia ose rezultati i bisedimeve sërish duhet t'i kthehet Kuvendit, i cili është organi i vetëm që marrëveshjes së mundshme (nëse arrihet!), i a

jep legjitimimin, siç ia jep çdo ligji, i cili pastaj zbatohet nga Qeveria ose siç bën ratifikimin e të gjitha marrëveshjeve ndërkombëtare me dy të tretat e të gjithë deputetëve të Kuvendit, që do të thotë për Marrëveshjen e Normalizimit me Serbinë duhet të votojnë 80 deputetë nga 120 sa i ka Kuvendi ynë. E gjithë çështja është: Cilësia e marrëveshjes së arritur! Këtu duhet të bëhet i tërë përqendrimi i Delegacionit të Qeverisë në bisedimet e Brukselit. Cilësia është e rëndësishme, kur të jetë arritur kjo, ratifikimi i saj në Kuvend nuk do të duhej të ishte problemi!

Prandaj, është e rëndësishme kur përfaqësuesit e popullit e kanë saktësinë gjuhësore në të folur e në të shkruar. E ata, sa herë i drejtohen opinionit publik, duhet ta dinë se jo të gjithë shqiptarët janë analfabetë potencialë!

Ndërsa opozita në konstelacionin e ri të forcave në Kuvend duhet të bëhet pjesë e delegacionit qeveritar të miratuar për ta dhënë kontributin e saj nga fillimi i dialogut, kuptohet duke lënë anash retorikën e fjalëve, pjesëmarrja e opozitës në delegacionin e Qeverisë për bisedime është e rëndësishme për vendin dhe pa dyshim ndihmon në cilësinë e marrëveshjes.

Tani koalicioni i ka numrat edhe pa Listën serbe. Votimi i së shtunës e konfirmoi këtë.



Përfundon me sukses faza e parë e garës së inteligjencës 'Eureka 6'

Prishtinë, 16 dhjetor (ER) - Gjymnazi "Hasan Nahi", në kuadër të Fondacionit për Arsim dhe Kulturë "Atmosfera", ka organizuar edicionin e gjashtë me radhë, garën e inteligjencës "Eureka 6". Gara e inteligjencës "Eureka 6" të shtunën ka sfiduar dijen e rreth 2 000 nxënësve më të mirë nga e gjithë Kosova të përzgjedhur nga klasat e 9-ta nga 26 komuna të ndryshme të Kosovës. Në mesin e rreth 2 000 nxënësve sa ishin pjesëmarrës në këtë garë do të përzgjidhen 250 finalistë të cilët do të garo-

jnë në fazën finale të garës "Eureka 6" që do të mbahet më 23 mars të vitit 2019, në orën 11:00, në ambientin e Gjymnazit "Hasan Nahi" në Prishtinë.

Me këtë rast, drejtori i Gjymnazit "Hasan Nahi", Fatih Bamja, ka falënderuar MASHT-in dhe të gjitha drejtoritë arsimore për mbështetjen dhe seriozitetin e treguar për realizimin e këtij projekti prestigjioz dhe shumë të rëndësishëm. "Qëllimi dhe synimi i organizimit të kësaj gare është që të gjithë bashkërisht t'i dalim zot brezit të ri të

vendit tonë duke i inkurajuar dhe motivuar për dijen dhe shkencën, njëkohësisht për ta rritur cilësinë e arsimit i cili llogaritet si investimi më i mirë për një të ardhme më të ndritur dhe të sigurt për atdheun tonë", është shprehur Bamja, duke shtuar se puna më e madhe që mund të bëhet në një vend është pikërisht përpjekja në fushën e arsimit. Rezultatet e fazës së parë të kësaj gare mbarëkombëtare priten të dalin më 21 dhjetor, ku do të shpallen 250 finalistë.

Donjet Bislimi: Aktivizmi i rinisë është energjia e Dekadës së Re

PRIZREN, 16 DHJETOR (ER) - Në vijim të ligjëratave dhe takimeve rreth aktivizmit politik, të ndërmarra nga Rinia Demokratike e Kosovës (RDK), të cilat u mbajtën në Prizren, Suharekë, Has dhe Zhur, Donjet Bislimi ka diskutuar rreth rëndësisë së përfshirjes së rinisë në çështjet që i takojnë rinisë dhe vendit.

Bislimi ka ftuar rininë që të bëhet pjesë e angazhimit, përkushtimit dhe kontributit për platformën e Dekadës së re, me çështjet jetike për rininë brenda kësaj platforme. "Dekada e Re është vizioni që ju ndërtoni dhe kontribuoni për ta realizuar atë duke qenë të bashkuar. Aktivizmi juaj është energjia e kësaj platforme, andaj të gjithë ne bëhemi edhe kreatorë edhe përcaktues të drejtimit nga

do të ecim ne dhe vendi njëkohësisht", ka theksuar Donjet Bislimi, i cili ka shtuar se në çdo aktivizim politik duhet të ketë angazhim të pandërprerë për realizimin e synimeve.

Donjet Bislimi, së bashku me ligjëruesit e tjerë nga Partia Demokratike e Kosovës, kanë vënë në dukje gjithëpërfshirjen dhe rëndësinë e angazhimit të rinisë në secilin lokalitet dhe lagje, për t'u bërë pjesë e zhvillimit dhe proceseve pozitive të vendit.

Takimet dhe ligjëratat për aktivizmin politik janë duke u zhvilluar në të gjitha degët e PDK-së, duke zgjuar interesimin e të rinjve për debat, diskutim dhe pasurim të platformës së Dekadës së Re.



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka udhëtuar të dielën për në Nju Jork

Thaçi: Ushtria e Kosovës është proces i pakthyeshem

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, para nisjes në Nju Jork, ku sot (e hënë) do të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ka thënë se Kosova ka bërë hapa të jashtëzakonisht në dy ditët e fundit, duke themeluar ushtrinë dhe ekipin negociator për dialogun me Serbinë. Ai ka thënë se ushtria e Kosovës është proces i pakthyeshem

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka udhëtuar të dielën për në Nju Jork, ku do ta përfaqësojë Kosovën në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Para nisjes për në ShBA, presidenti Thaçi ka mbajtur një konferencë për media në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", në të cilën ka folur për formimin e ushtrisë së Kosovës dhe votimin e rezolutës së dialogut në Kuvend të propozuar nga PSD-ja.

Presidenti Thaçi ka thënë se, pavarësisht prej diskutimeve që do të ndodhin në OKB, ushtria e Kosovës është një proces i pakthyeshem dhe se vetëm do të zhvillohet e fuqizohet më tepër. "Pjesëmarrja e komuniteteve në ushtrinë e Kosovës është një vlerë shumë e çmueshme. Kemi rreth 10 për qind komunitete joshqiptare të përfshira, 5 për qind janë serbë. Në parakalimin që kanë bërë në kazermën kryesore, kam

takuar pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme të cilët ndihen mirë dhe komod për t'i shërbyer vendit tonë", ka thënë Thaçi.

Ai ka shtuar se ushtria e Kosovës do të krijojë paqe, stabilitet dhe do t'i kryejë obligimet e veta. "Do të punojmë shumë për t'i implementuar të gjithë hapat e tjerë. Ushtria është një proces i pakthyeshem dhe vetëm sa do të zhvillohet dhe fuqizohet më shumë. Ushtria do ta dërgojë mesazhin më të mirë të tolerancës dhe harmonisë për të gjithë njerëzit. Sot kam takuar qytetarë serbë që ndihen mirë me vendimet e Kuvendit të Kosovës dhe në të njëjtën kohë duan t'i shërbejnë vendit. Nëse Serbia është zemëruar dhe shqetësuar, serbët e Kosovës ndihen rahat", ka deklaruar Thaçi.

Presidenti Thaçi ka folur edhe për rezolutën e cila u votua të shtunën në Kuvendin e Kosovës, ku edhe u votua ekipi dialogues. "Pas themelimit të ushtrisë, lajmi tjetër i rëndësishëm ka qenë votimi në Kuvendin e



Kosovës nga deputetët, të një rezolute dhe një ekipi sa të më të gjerë politik për t'u përgatitur edhe më mirë për fazën finale Kosovë - Serbi. Ky dialog do të jetë final me një marrëveshje të përhershme që do të rezultojë

me njohjen reciproke të Serbisë ndaj Kosovës dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB. Edhe në këtë fazë kam besim që ai ekip i gjerë politik dhe shoqëria civile së bashku do t'ia dalim me sukses dhe do ta përmbyllim njëherë e

përgjithmonë kapitullin e errët. Ne duam që e kaluara të mbetet e kaluar, të punojmë për të ardhmen për një njohje reciproke të Serbisë dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB", ka thënë Thaçi.

Largohen 803 deponi ilegale mbeturinash

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Fushata tremujore për pastrimin e Kosovës, e filluar më 15 shtator të këtij viti, ka përfunduar pas tre muajve të aktiviteteve të shumta në tërë Kosovën. Gjatë kësaj periudhe me angazhimin e institucioneve, "Let's Do It Kosova" e mijëra vullnetarë, janë larguar 803 deponi ilegale dhe shumë mbeturina përreth rrugëve e në hapësira publike. Fushata për pastrimin e Kosovës ka mobilizuar rreth 10 për qind të popullsisë së Kosovës, me rreth 200 mijë qytetarë anekënd Kosovës. Si rezultat i suksesit që ka arritur kjo fushatë "Let's Do It World ka shpallur Kosovën shtetin më aktiv dhe më të suksesshëm në fushatën "World Cleanup Day 2018".

Me rastin e përfundimit të fushatës, ministri i Mjedisit dhe

Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi dhe drejtori i "Let's Do It Kosova", Luan Hasanaj, kanë falënderuar anëtarët e task forcës për angazhimin e tyre institucional, komunitet, shoqërië civile, vullnetarët, mediat dhe gjithë qytetarët e Kosovës për angazhimin e tyre për pastrimin e Kosovës. Pas përfundimit të kësaj fushate, më 10 janar 2019 do të mbahet ceremonia e ndarjes së çmimeve për komunitet më aktive dhe më të suksesshme të kësaj fushate, e të cilat do të shpërblehen me fonde për realizimin e projekteve në fushën e mjedisit për vitin 2019.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe "Let's Do It Kosova" u kanë bërë thirrje komunave që pas kësaj fushate të pastrimit të angazhohen për mirëmbajtjen e hapësirave publike, të mos lejojnë krijimin e deponive të reja ilegale, ta zbatojnë udhëz-



imin për ndëshkime me gjoja mandatore, të punojnë për shtrirjen e shërbimeve për mbeturina, si dhe krijim të zonave të gjelbra. Gjithashtu, ata bëjnë apel te qytetarët për moshedhjen e mbeturinave

jashtë vendeve të caktuara për ta mbajtur Kosovën të pastër. Në fund të kësaj fushate ministri Matoshi është deklaruar se angazhimi i tij dhe i ministrisë që ai drejton do të vazhdojë edhe më tej për krijimin e një

sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë nëpërmjet trajtimit efikas të tyre, duke reduktuar ndotjen e mjedisit dhe duke shndërruar ato në përfitime për vendin.

Prizreni nderon dëshmorët e kombit

PRIZREN, 16 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka bërë homazhe të varrezat e dëshmorëve në Landovicë të kësaj komune. Gjatë homazheve, Haskuka ka qenë i shoqëruar nga veteranët e UÇK-së dhe gjenerali Enver Cikaqi. Me këtë rast, Haskuka

ka thënë se dëshmorët janë më meritoret për themelimin e ushtrisë së Kosovës. "Në Landovicë së bashku me gjeneralin Enver Cikaqi dhe veteranët e UÇK-së përkujtuam më meritoret për Ushtrinë e Kosovës, dëshmorët e kombit. Lavdi dëshmorëve! Urime ushtria!", ka thënë Haskuka.



Rrugët e Ferizajt të pastruara nga bora

FERIZAJ 16 DHJETOR (ER) - Makineri të rënda dhe ekupe të shumta mobile kanë dalë në orët e para të mëngjesin të së dielës në të gjitha rrugët e territorit të Ferizajt për t'i pastruar akset rrugore nga reshjet e dendura të borës.

Komuna e Ferizajt ka theksuar se një gatishmëri e tillë e gjithë mekanizmit reagues nuk është parë në të kaluarën, ku shumë rrugë ishin të bllokuara për ditë me

radhë. "Kjo falë përkushtimit të qeverisjes lokale dhe kujdesit të të parit të Ferizajt, Agim Aliu, që të përmbyllë me kohë gjithë procedurën e tenderimit për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve në gjithë territorin e Ferizajt. E gjithë zona rurale dhe ajo urbane është e mbuluar në kuadër të këtij operacioni mirëmbajtjeje, përkatësisht pastrimi të rrugëve nga bora. Nga raportimet e terrenit, dëshmohet

se të gjitha rrugët janë të kalueshme dhe vazhdimisht po intervenohet nga operatorët ekonomikë dhe ndërmarrje publike për hapjen e rrugëve, gjegjësisht pastrimin e tyre nga reshjet e borës", ka njoftuar Komuna e Ferizajt. Kjo komunë ka ftuar edhe qytetarët që të mobilizohen përkaj vendbanimeve të tyre, përkatësisht pronave të tyre në heqjen e borës, që të lehtësohet qarkullimi edhe aty ku mund të ketë pengesa.



Vetëvendosja: Prishtina po ngulfatet nga mbeturinat

Prishtinë, 16 dhjetor (ER) - Aktivistë të Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë kanë zhvilluar të dielën një aksion simbolik përmes të cilit adresuan çështjen e papastërtisë në gjithë Komunën e Prishtinës, duke ekspozuar fotografi të deponive të vogla dhe të mesme në lagjet dhe fshatrat e Prishtinës.

Asambleisti Mirsad Vitia ka thënë se edhe pse kjo çështje ka qenë prioritet në fushatën zgjedhore të vitit 2017, gjendja në Komunën e Prishtinës sa i përket

mbeturinave po shkon duke u përkeqësuar. "Asambleja komunale u zhblokua, inkasimi tashmë po bëhet direkt nga komuna dhe meqë është lidhur me tatimin në pronë dhe kushtëzohet me regjistrim të veturave, llogaritë që inkasimi është i rregullt. Nuk ka as edhe një arsye që Prishtina të vazhdojë të mbetet e mbuluar nga mbeturinat", ka theksuar Vitia.

Edhe aktivistja Teuta Hasani-Ahmeti ka thënë se premtimet për Prishtinë të pastër përfshinin një planifikim logjistik dhe koor-

dinim të orarit të mbledhjes së mbeturinave si dhe reforma në faturim. "Edhe sot e kësaj dite mbeturinat mblidhen gjatë ditës dhe të shpeshta janë rastet kur shkaktohet kaos në trafik, ani pse ishte premtuar që kjo të bëhet gjatë mbrëmjes. Po ashtu, faturimi nuk ka ndryshuar fare dhe nuk ka klasifikim në këtë aspekt fare", ka theksuar ajo.

Aktivistët e Vetëvendosjes pas-truan borën nga shkallët në Sheshin "Adem Jashari", i cili është vetëm 30 metra larg Komunës së Prishtinës.

Edhe 25 shtëpi të reja për skamnorët do të ndërtohen në Skenderaj

SKENDERAJ, 16 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari dhe kryetari i Shoqatës "Jetimat e Ballkanit", Halil Kastrati, kanë nënshkruar një marrëveshje të bashkëpunimit për ndërtimin e 25 shtëpive të reja në këtë komunë.

Jashari nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ka bërë me dije se sipas kësaj marrëveshjeje, Komuna e Skenderajt do të ndajë 125 mijë euro për ndërtimin e këtyre shtëpive. "Edhe 25 shtëpi të reja do t'i ndërtojmë në vitin 2019, të dedikuara për familjet me kushte të rënda banimi falë bashkëpunimit dhe mirëkup-

timit që kemi me hoxhën Halil Kastrati dhe Shoqatën 'Jetimat e Ballkanit', me të cilën kemi nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit për realizim të këtij projekti, ku ne si Komunë e Skenderajt do të participojmë me 125 mijë euro (5 000 euro për çdo shtëpi), ndërsa pjesën tjetër Shoqata 'Jetimat e Ballkanit'. Kam marrë premtim nga hoxhë Halili se numri i shtëpive që do të ndërtohen do të jetë më i lartë se 25. Jam jashtëzakonisht i lumtur që po kontribuojmë për ta zgjidhur çështjen e banimit të familjeve nevojtare të Komunës së Skenderajt", ka shkruar Jashari.



Bien eksportet e Kosovës në Serbi

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Eksportet, edhe ashtu të vogla të Kosovës në drejtim të Serbisë, kanë shënuar rënie për 50 për qind që nga vendosja e taksës doganore 100 për qind për produktet e importuara me origjinë nga Serbia. Brenda një muaji nga vendosja e taksës fillimisht 10 për qind dhe me pas 100 për qind, Kosova ka eksportuar në Serbi mallra në vlerë prej 2.7 milionë eurosh, ndërkohë në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar Kosova kishte eksportuar në Serbi produkte në vlerë mbi 4.5 milionë euro.

Produktet që Kosova eksporton në Serbi, sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, janë kryesisht bujqësore. Qeveria e Kosovës, më 6 nëntor, me arsyetimin për mbrojtje të produkteve vendore, vendosi taksë 10 për qind për produktet e importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, kurse më 21 nëntor vendosi që këtë taksë ta rrisë për 100 për qind.

Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës dhe përfaqësues të bizneseve thonë të mos jenë raportuar raste nga bizneset se mund të jetë shkaktuar ndonjë problem gjatë importit të produkteve të Kosovës në Serbi por që, sipas tyre, edhe tentativat e bizneseve të Kosovës për të

eksportuar në Serbi vazhdojnë të jenë minimale.

Haki Shatri, këshilltar për ekonomi i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se eksporti në Serbi është i ulët pikërisht për shkak të barrierave që ky shtet ua ka paraqitur bizneseve nga Kosova.

"Kryeministri Haradinaj ka takime të kohëpaskohshme me asociacionet e bizneseve, shoqatat prodhuese të bizneseve dhe diskutojmë problemet që eventualisht mund të dalin nga taksa 100 për qind, por që bizneset nuk kanë theksuar probleme gjatë eksportit të tyre në Serbi. Si duket autoritetet e Serbisë janë përcaktuar që të mos marrin masa, por duhet theksuar se edhe ky eksport është i vogël është simbolik në krahasim me importet", ka thënë Shatri.

Sipas të dhënave zyrtare, eksportet e Kosovës në Serbi në vitin 2017 ishin 48 246 milionë euro, kurse importet ishin 449 milionë euro.

Ndërkohë, kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit, Agim Shahini, ka bërë me dije për "Radion Evropa e Lirë" se Serbia në vazhdimësi u vendos barriera bizneseve të cilat importojnë në Serbi, duke mos njohur dokumentet të cilat lëshoheshin nga autoritetet e



Kosovës. "Pas taksës 100 për qind nuk është raportuar për ndonjë problem që bizneset nga Kosova mund të kenë pasur gjatë eksportit të produkteve të tyre në Serbi, por që eksporti është i ulët dhe prodhuesit nga Kosova, duke i parë barrierat që vendos Serbia, nuk e shohin si treg Serbinë. Taksa doganore prej 100 përqindësh mund të ketë rritur vetëdijen e institucioneve shtetërore të Serbisë që të mos vendosin barriera pasi që

problemet kanë qenë të lajmëruara më pak nga bizneset tona, por edhe tentativa për eksporte në Serbi ka pasur shumë më pak pas taksës", ka deklaruar Shahini.

Marrëdhëniet tregtare të Kosovës me Serbinë janë përcjellë në vazhdimësi me probleme të shumta. Barrierat tregtare që shteti i Serbisë ua kanë vënë produkteve nga Kosova kanë qenë të shumta. Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina vetëm pak muaj

pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008 patën ndaluar produktet e Kosovës në tregjet e tyre për shkak të ndërrimit të vulës së doganave nga ato të UNMIK-ut në Doganat e Kosovës. Kjo gjendje kishte vazhduar deri në vitin 2011, kur Qeveria e Kosovës pati vendosur masa të plota reciproke për produktet e Serbisë, ndërsa taksë doganore prej 10 përqindësh për të gjitha mallrat që vinin nga Bosnja e Hercegovina.

AZHB-ja: Makineria bujqësore pa numër serik nuk do të rimburohet



PRISHTINË, 16 DHJETOR (ER) - Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) ka njoftuar të gjithë fermerët përfitues të granteve investive, sidomos ata që në planet e tyre të biznesit kanë paraparë blerjen e makinerisë bujqësore, që të kenë kujdes të shtuar gjatë blerjes së tyre, pasi disa prej këtyre pajisjeve janë identifikuar pa numër serik dhe të dhëna teknike. Për këtë arsye, AZHB-ja ua ka tërhequr vërejt-

jen fermerëve përfitues që të kenë kujdes gjatë blerjeve, furnizimit me këto pajisje ngaqë makineritë dhe pajisjet pa numër serikë dhe të dhëna teknike nuk do të rimburohen.

Drejtoria e Autorizimit të Pagesave në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë ka njoftuar se gjatë procesit të autorizimit të pagesave janë paraqitur mangësi në implementimin e projekteve, e sidomos për

blerjet, furnizimin me makina bujqësore dhe pajisje të ndryshme, të cilat përfituesit i kanë planifikuar në planet e tyre të biznesit. Gjatë analizave për implementimin e projekteve janë identifikuar makina bujqësore dhe pajisje pa numër serik dhe të dhëna teknike që, sipas nenit 31, paragrafi 1.6 dhe 1.7 të Udhëzimit Administrativ 05/2018 dhe nenit 44 paragrafi 1.6 dhe 1.7 i U/A, 09/2018, janë shpenzime të papranueshme.

Ministria e Infrastrukturës ndërmer masa për mirëmbajtjen e rrugëve

PRISHTINË, 16 DHJETOR (ER) - Pas rënies së borës të dielën, Ministria e Infrastrukturës ka njoftuar se të gjitha rrugët regjionale, nacionale dhe autoudhët në Kosovë janë të kalueshme, por që kërkohet nga ngasësit të mos udhëtojnë pa pajisje dimërore dhe ta përshatnin shpejtësinë sipas shenjave të komunikacionit.

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka bërë me dije se që nga mesnata e së dielës, kur edhe kanë filluar reshjet e para të borës, kompanitë e kontraktuara nga ministria i kanë ndërmarrë masat e nevojshme për mirëmbajtjen e rrugëve, në mënyrë që ato të jenë të kalueshme dhe të sigurt për qarkullim rrugor. "Në orët e para të mëngjesit jam

informuar nga të gjithë menaxherët rajonalë se kompanitë e kontraktuara janë duke punuar për pastrimin e rrugëve nga bora. Si rezultat, qytetarë të dashur, këtë të diel mund të lëvizni lirshëm. Kujdes me shpejtësinë dhe mos udhëtoni pa pajisje dimërore. Fundjavë të këndshëm!", ka thënë ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj.



Në 18-vjetorin e shuarjes fizike

Jashar Salihu, hero i veçantë i Kosovës

Lulëzim ETEMAJ

Që në fillim të Aksionit për Pajtimin e Gjaqeve në Kosovë, në vitin 1990, ndër personat e parë, ish të burgosur politikë, ku do të drejtoheshim për ndihmë, ishte Jashar Salihu. Ashtu siç kishim pritur, ai nuk do të ngurronte aspak për të na ndihmuar dhe, në këtë mënyrë, edhe për të na dhënë forcë që ta tejkalonim shijen e hidhur që na e kishte shkaktuar refuzimi "diplomatik" që kishim marrë nga disa ish të burgosur të tjerë politikë, më të moshuar, të trevës së Dukagjinit.


Anëtari i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ), i angazhuar në Komitetin e Deçanit, kështu, pas 4 vitesh të kaluara në burgjet serbe, po ridëshmonte bindjen e tij se rruga e çlirimit të Kosovës dhe viseve të saj, në radhë të parë duhet të kalojë përmes pajtimit dhe bashkimit të shqiptarëve, se çlirimi, në mos i pamundur, do të jetë një proces tejet i vështirë po qe se do t'i gjente shqiptarët në hasmëri me njëri-tjetrin. Dhe, kështu, po e nderonte edhe drejtuesin dhe bashkëveprimtarin Jusuf Gërvalla; zgjedhja që i kishte bërë për bashkëpunëtor sërish po ridëshmohej e qëlluar.

Prandaj, duke e përvetësuar si moto jetësore thënien e Jusufit: "Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli", Jashar Salihu do të jetë i pandalshëm.

Ai do të troket në sa e sa dyer, dhe në bashkëbisedim me ta nëpër oda do t'i lus shqiptarët me tërë qenien e tij që të mbyllnin hasmëritë, të falnin njëri-tjetrin, ta shtrinin dorën e pajtimit-të bashkoheshin.

Faktikisht kjo lutje dhe lutjet tjera të natyrës së tillë, ishte lutja e vetme që njihete në tërë jetën e tij Jashar Salihu. Dhe, ai dinte se kur duhej edhe të dilte në ballë. Jo rastësisht, më 1 maj të vitit 1990, do ta drejtojë tubimin te Verrat e Llukës, ku kishte më se 500 mijë të pranishëm nga të gjitha trevat shqiptare, ku do të arriheshin 106 pajtime; 62 gjaqe, 25 plagë dhe 19 ngatërresa.

Një fakt që s' duhet harruar me këtë rast: tubimi, fillim e mbarim ishte vrojtuar nga policia serbe, e cila për të demonstruar forcën e vet kishte ardhur edhe me një mori autobлиндash dhe pjesëmarrësit në tubim i kishte vënë në një rrethim të hekurt. Prandaj, për t'ia kujtuar se nuk e kishin harruar "fajin" që kishte bërë Jashar Salihu, në fund të këtij viti e arrestojnë dhe e torturojnë tmerrësisht, barbarisht. Por, asgjë nuk përfundon me kaq; ndjekja e tij do të vazhdojë edhe më tutje, në çdo hap, gjer aty sa ta detyrojnë të marrë rrugën e mërgimit. Mirëpo, ai nuk ishte nga ata djem të Kosovës që largësia nga atdheu do t'ia zbehte apo shuante dashurinë dhe përkushtimin për lirinë e tij. Përkundrazi, veprimtaria e tij politike, në kuadër të Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK), vetëm se do të shënojë ngritje dhe do të marrë dimensione të reja, të shumanshme; duke qenë paraprakisht në hierarkinë më të lartë drejtuese të saj, me nismën e tij në vitin 1993, do të formohet Fondi "Vendlindja



thërret", fond i cili fillim e mbarimin ka qenë në funksion të formimit- financimit të luftës çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Që nga ky vit, pra që nga koha e themelimit, Jashar Salihu ka qenë kryetar i Këshillit për Administrimin e Fondit "Vendlindja thërret". Porse, ai nuk ishte njeri i zyrës, nuk dinte dhe nuk ia ka lejuar kurrë vetes që ta kalojë kohën vetëm në të. Në kontakte të vazhdueshme me bashkatdhetarë ka derdhur të gjithë energjinë tij, në mënyrë që fondi të fuqizohej me mjete; që, kështu, për ushtarët e UÇK-së të siguroheshin sa më shumë armë dhe pajime të luftës. Dhe, fjala e tij, dhe shembulli i tij, kanë gjetur gjithnjë përkrahje. Ndryshe nuk mund të mendohet të ndodhte me një njeri të devotshëm gjer në vetëmohim, siç ishte Jashar Salihu, i cili me ditë dhe net të tëra, për shkak të aktivitetit në shërbim të luftës në Kosovë, nuk mund të kthehej dhe të shijonte ngrohtësinë familjare, ta pushonte qoftë vetëm për pak çaste trupin e dërrmuar nga torturat nëpër burgje pranë

bashkëshortes dhe fëmijëve të tij.

Ai as nuk kishte makinë e as nuk dinte si ishte të ulej në restorante a hotele, për ta ngritur një gotë apo për ta ngrënë një kafshatë bukë. Janë të panumërta netët kur Jashari kthehej tejet vonë nga tubimet me bashkatdhetarët, nga takimet me diplomatë perëndimorë apo përfaqësues të mediave, dhe në redaksinë e "Zërit të Kosovës", ku ishte edhe zyra e Fondit "Vendlindja thërret", merrte për të ngrënë një kafshatë bukë, shpeshherë të sa e sa ditëve më parë, me një domate a me peshk të konservave (ushqimi më i lirë në Zvicër) dhe pinte ndonjë gotë ujë nga uji natyral apo, po të ndodhej, i gazuar, ndërkaq që çantën e kishte përplot me para. Thjesht, ishte e paparamendueshme që në radhë të parë të mos ndodhte për t'u afruar dhe pyetur se si shkojnë punët me gazetën, a ka informata nga fronti i luftës në Kosovë, dhe, duke qenë edhe në kontakt të vazhdueshëm edhe me drejtuesit tjerë politik dhe ushtarak të luftës, përfshirë edhe luftëtarët e lirisë në vija të frontit, të sillte

informata të dorës së parë.

Para opinionit ndërkombëtar i thoshte troç aspiratat e Kosovës

Këtë privilegj nuk e ka gëzuar vetëm "Zëri i Kosovës". Janë të shumta mediat perëndimore, të cilat duke qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me të, për lexuesit e tyre plasonin top informata nga lufta në Kosovë, duke përhapur kështu edhe të vërtetën e kësaj lufte, ashtu siç janë të shumtë gazetarët dhe reporterët që kanë hyrë në Kosovë përmes tij, për të raportuar prej andej.

"Shqiptarët e Kosovës janë evropianë dhe nuk kanë lidhje me vendet islamike. Ata janë të vendosur të luftojnë deri në fund", i ka deklaruar Jashar Salihu gazetës amerikane "The Christian Science Monitor" të datës 16 prill 1998, duke mbrojtur kështu dhe përhapur të vërtetën për shqiptarët dhe vlerat civilizuese perëndimore, të luftës së UÇK-së, njëkohësisht duke demantuar propagandën antishqiptare të regjimit kriminal të Millosheviqit dhe satelitëve të tij. Prandaj, në sensibilizimin e opinionit perëndimor me të vërtetën për luftën e drejtë të Kosovës kundër forcave kriminale të Millosheviqit, roli i Jashar Salihut është i pazëvendësueshëm, dhe, rrjedhimisht, po dëshmohej se jorastësisht në kuadër të Drejtorisë Politike të UÇK-së, ishte anëtar i Grupit Diplomatik, i cili drejtohej nga përfaqësuesi politik i UÇK-së, politologu Bardhyl Mahmuti, dhe përbëhej edhe nga Ramadan Avdiu, Agush Buja, Bilall Sherifi, Sabri Kiçmari, Rexhë Ibërdemaj, Mujë Rugova dhe Pleurat Sejdiu, ndërkaq më vonë do të jetë përfaqësuesi i parë diplomatik i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, në Zvicër. Ana tjetër që e shquan atë, që nuk do duhej harruar për asnjë çast, është ajo se Jashar Salihu, ishte, siç thotë një fjalë, edhe i gishtit: këtë e ka dëshmuar sa e sa herë duke qenë krah për krah luftëtarëve të lirisë edhe në frontin e luftës, në detyra të karakterit të veçantë.

Jashari nuk dinte të moralizonte në raport me bashkatdhetarët. Gjithnjë printe me shembullin personal, dhe, me të drejtë, gjërat i thoshte troç: kërkonte prej tyre të përmbushnin gjithanshëm obligimin ndaj UÇK-së dhe lirisë së Kosovës, dhe e quante për fyerje që ky të degradohej duke u cilësuar si ndihmë.

"Kosova nuk ka nevojë për lëmoshë", thoshte ai, ndaj saj kemi obligime, vetëm borxhe. Troç i thoshte edhe para opinionit ndërkombëtar aspiratat e Kosovës, dhe tregonte rrugën që do të çonte në zgjidhjen e çështjes së saj: "Të vetmet bisedime të pranueshme midis shqiptarëve dhe Beogradit janë ato që do të përcaktonin kufijtë midis Serbisë dhe Kosovës", do të shprehej për të njëjtin numër të gazetës "The Christian Science Monitor".

Prandaj, duke qenë i brumosur me pikëpamje të tilla progresiste - duke e konsideruar borxhin ndaj Kosovës si diçka që kurrë s'mund të thuhet se tani është përmbushur, Jashar Salihu s'kishte se si të vdiste ndryshe, vetëm se me sy çelë.

Jetësimi i ushtrisë, akt i sendërtimit të plotë të shtetformimit të Kosovës



Arbër HADRI

Procesi jetik i mbetur i sendërtimit të shtetësisë së Kosovës dhe sigurisë kombëtare të saj u përmbyll në datën historike 14. 12. 2018 me inaugurimin e transformimit të Forcës së Sigurisë në ushtri të Kosovës. Entuziazmi që kemi pasur që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës është përsëritur me këtë akt të krijimit të ushtrisë, që ka një përkrahje gjithëpopullore. Arritja e këtij qëllimi është pjesë përbërëse e rrugëtimit të Kosovës drejt lirisë, pavarësisë dhe sendërtimit të shtetësisë së Kosovës. Një rrugë të gjatë me sakrificë shekullore të popullit shqiptar, dëshmorëve të kombit, heronjve të UÇK-së, guximit intelektual dhe tejkalimit të pengesave në marrëdhëniet ndërkombëtare për krijimin e ushtrisë dhe përmbylljen e shtetformimit, i erdhi fundi sot. Përkujtim të veçantë që asocion me ushtrinë e meriton komandanti legjendar Adem Jashari dhe e gjithë familja e shenjtë Jashari, me flijimin e së cilës për lirinë e vendit fillon edhe kryengritja e përgjithshme ushtarake në Kosovë.

Viti i ardhshëm që po troket shënon njëzetvjetorin e çlirimit të Kosovës dhe transformimit e UÇK-së në TMK-në e më pas në FSK-në, e cila kishte kryesisht ingerenca civile dhe ishte vënë nga Bashkësia Ndërkombëtare në vendnumërim pa një të drejtë elementare si shtet dhe popull, për të drejtën në mbrojtje nga agresioni i mundshëm ushtarak dhe rrezikimi i qenies së ekzistencës së tij. Paralele të analogjive historike botërore të ndaljes apo mbikëqyrjes së krijimit dhe zhvillimit të forcave ushtarake të shteteve sovra mund të tërhiqen vetëm në relacion me shtetet agresore të cilat kanë nxitur luftëra ekspansioniste ndaj popujve, territoreve të vendeve të tjera e që kanë evoluuar në konflikte regjionale dhe Botërore. Shembull pas Luftës së Dytë Botërore është rasti i Gjermanisë Perëndimore me "Forcat Mbrojtëse" dhe Japonisë me "Forcat Vetëmbrojtëse të Japonisë", të cilat kanë qenë të privuara për një kohë dhjetëvjeçare në themelimin e këtyre ushtrive dhe vetëm në cilësi vetëmbrojtëse brenda territorit të shtetit respektiv dhe nën mbikëqyrjen strikte të aleatëve. Zbatimi i këtij kuti në rastin e

Kosovës nuk përkon fare me krahasimin themelor ndërmjet rolit të viktimës dhe agresorit. Anomalia më e madhe në këtë këndvështrim është dënimi që i është nënshtruar Kosova si viktimë e luftës në moslejimin e krijimit të forcave të saj ushtarake dhe amnistisë së ushtrisë së Serbisë së Millosheviqit "Kasapit të Ballkanit". Ndryshimi i roleve të viktimës dhe agresorit, të ushtrisë e cila ka mbetur e papenalizuar përkundër faktit se ka masakruar dhjetëra mijëra njerëz të pafajshëm në Kosovë dhe ka ndërmarrë spastrimin etnik të një milion shqiptarëve, në krahasim me perspektivën e një ushtrie të Kosovës që do të prodhonte siguri dhe stabilitet, është e papranueshme dhe ka prodhuar ambiguitet të marrëdhënive të sigurisë në rajon.

Situata në të cilën ka kaluar Kosova në historinë e saj të shekullit XX me okupimin, aparteidin, shkeljet e të drejtave themelore njerëzore dhe luftën, si dhe me situatën aktuale të ndryshimeve të shpejta e të paparashikueshme në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe pa qartësinë e rrjedhave të misionit të sigurisë ndërkombëtare në Kosovë, e kanë vendosur në renditjen e parë të Sigurisë Kombëtare të Kosovës krijimin e menjëhershëm të ushtrisë së saj. Ndajja e prolongimit edhe më tutje të këtij procesi strategjik për Kosovën, nëse e shikojmë në formë objektive situatën, duhet t'i atribuohet kryeministrit Ramush Haradinaj i cili i parapriu me vendosjen me këmbëngulje në këtë agjendë kohore procesin dhe pa asnjë hezitim qartësoi qëndrimin e palëkundur të shtetit të Kosovës para opinionit publik të brendshëm dhe atij ndërkombëtar, për vendimin për ndryshimin e mandatit të FSK-së e Ministrisë së Mbrojtjes dhe themelimin e zhvillimit të ushtrisë së Kosovës. Mosveprimi nga ana e tij do të nënkuptonte shtyrje pa përcaktim kohor të krijimit të ushtrisë. Ky qëndrim i prerë vuri në lëvizje dhe pozicionim të imponuar Fuqitë e Mëdha, me ç'rast Amerika si aleatja dhe mbështetëse kryesore e shtetësisë së Kosovës miratoi përmbylljen e një procesi i cili, nëse do të vazhdohej me ngurrim dhe pritje, do të kishte ndikim të kundërt, prodhimin e pasigurisë dhe të destabilitetit potencial të Kosovës dhe me këtë edhe të rajonit të Evropës Juglindore.

Rruga e transformimit institucional të FSK-së dhe të Ministrisë në hap me ndërtimin e shtetit të Kosovës ka qenë mjaft e gjatë. Konteksti i rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë në vitin 2012

pas periudhës pesëvjeçare të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, për kompetenca shtesë që derivonin nga Plani i Ahtisarit për rishikimin e mandatit të FSK-së, u shpërfaq në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. Përkundër një mobilizimi fillestar kjo qasje u sfidua nga Bashkësia Ndërkombëtare në vartësi nga konstelacionet e forcave brenda shteteve anëtare të NATO-s, e cila promovonte një qasje neutrale përballë kësaj çështjeje, qëndrim i përcaktuar në vitin e pavarësisë 2008. Kjo pikëpamje u nxit edhe nga pikëpyetja e ndërveprimit me misionin dhe praninë ndërkombëtare ushtarake dhe civile në Kosovë, bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, si dhe të pozitës së minoriteteve. Pjesë e këtyre ndërveprimeve ishin edhe qëndrimet kundërtënëse brenda skenës politike në Kosovë dhe zgjedhjet politike në sipërfaqe. Përkundër këtyre obstrukcioneve edhe në atë kohë institucionet e Kosovës tentuan disa herë që të vazhdojnë me transformimin e ushtrisë, fillimisht me ndryshime kushtetuese në Kuvend, e më pas edhe me ndryshime të ligjeve për transformimin e FSK-së dhe të Ministrisë së Mbrojtjes. Iniciues në të dyja rastet ka qenë ish-kryeministri Thaçi, i cili mundësoi që Bashkësia Ndërkombëtare të provonte të siguronte për një periudhë kohore përkrahjen e minoritetit serb për ndryshime Kushtetuese për krijimin e ushtrisë, në të kundërtën pas kësaj periudhe Kosova do ta konsumonte këtë marrëveshje parimore me Bashkësinë Ndërkombëtare, si dhe të drejtën e saj sovra për formimin e ushtrisë.

Mirëpo, fjala përfundimtare për miratimin e ushtrisë së Kosovës, mirëmbajtjen e paqes në rajon dhe mbajtjen nën kontroll të qëndrimit dhe të anëtarëve të NATO-s e cila ka misionin kryesor të sigurisë KFOR-in në Kosovë, i takon superfuqisë botërore Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që dhe një herë e dëshmoi se jo vetëm që është përkrahëseja më e madhe e jona, por edhe se Kosova e pavarur dhe sovra është produkt i saj. Shtylla kryesore për këtë qëndrim të administratës Amerikane është Sekretari i Mbrojtjes James N. Mattis. Në një shkrim të mëparshëm para disa muajsh dhe para vendosjes në tavolinë të kësaj çështjeje, kam theksuar se roli i gjeneralit Mattis si një ndër personat më të besuar të presidentit Trump është baza

themelore e përkrahjes së tanishme Amerikane ndaj Kosovës dhe mund të cilësohet Hero modern i Kosovës. Mbizotërimi i elementit ushtarak me gjeneralët në krye të institucioneve më të rëndësishme të sigurisë kombëtare amerikane, ka mundësuar përfshirjen e trashëgimisë ushtarake që ka qenë pjesë përbërëse e planifikimeve ushtarake për çlirimin e Kosovës, duke e mbajtur një relacion të kontinuitetit në politikën e jashtme amerikane ndaj Kosovës. Ky qëndrim përballë themelimit të Ushtrisë së Kosovës, u dëshmuua nga Sekretari i Mbrojtjes gjenerali Mattis gjatë takimit me kryeministrin e Kosovës Haradinaj në Pentagon, me dhënien e pëlqimit Amerikan ndaj iniciativës për transformimin e FSK-së në Ushtri, si dhe tani me ushtrimin e rolit Amerikan në NATO-në në favor të krijimit të Ushtrisë së Kosovës.

Pas kornizës ligjore të themelimit të Ushtrisë së Kosovës mbesin në proces një sërë çështjesh që duhet të adresohen e që janë me rëndësi për sigurinë dhe stabilitetin e Kosovës. Çështja e parë është ajo e ridefinimit pozitiv të marrëdhënive me KFOR-in, misionin e NATO-s në Kosovë, që në fakt mund të shfrytëzohet gjatë kësaj periudhe transitore edhe për sforcimin e sigurisë në pikat nevralgjike të Kosovës. Bashkëveprimi është i domosdoshëm gjatë periudhës së ngritjes së kapaciteteve të Ushtrisë së re të Kosovës dhe të pranimit të saj në NATO-në, kur edhe misioni i saj do të transformohej në nivelin e sigurisë së përgjithshme të anëtarëve të Organizatës. Kjo është e vetmja qasje në horizont dhe e favorshme për Kosovën, duke e marrë parasysh fqinjën Serbinë i cila ka pretendime territoriale ndaj Kosovës dhe është rreziku kryesor destabilizues ndaj saj.

Themelimi i ushtrisë mbart në vete edhe përgjegjësi shtetërore që janë të pa negociueshme dhe të padiskutueshme. Përkrahja e zhvillimit të kapaciteteve mbrojtëse ushtarake të Kosovës në nivel kompatibil me ushtritë e shteteve që e rrethojnë dhe përballja e fuqishme dhe e sukseshme me rreziqet e mundshme, është esenciale për sigurinë e Kosovës. Kosovës i nevojitet një ushtri kredibile dhe me fuqi reale, gjersa krijimi i mundshëm i iluzioneve të madhështisë duke evituar përkrahjen buxhetore, duhet të hidhet poshtë me çdo kusht nga klasa politike e Kosovës, e tanishmja dhe ajo në ardhje. Përkundër faktit që misioni themelor i Ushtrisë së Kosovës është mbrojtja dhe limitohet me ligj nga armët e rënda sulmuese si

tanket, veprimet e mundshme ushtarake janë të panumërta. Doktrina ushtarake e armëve të sofistikuara moderne me precizitet të lartë me origjinë Amerikane, sikurse raketat anti-tank Javelin me rreze radiusi 5 km të pakapërcyeshme për çdo tank; artileri të sofistikuara; si dhe më pas në prag të anëtarësimin të NATO të sistemit raketor antiajror nën mbikëqyrjen e SHBA-ve, sigurisht që duhet të jetë në agjendën e planifikuesve të strukturës së ushtarëve me karrierë të ushtrisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës. Po ashtu, mundësia e krijimit të industrisë vendore për prodhimin e armëve të lehta dhe municionit ushtarak të nevojshëm duhet të merret parasysh. Korniza kohore e parashtruar prej 10 vite për plotësimin e tërësishëm të planifikimeve ushtarake për krijimin e kapaciteteve të plota të ushtrisë sonë, nëse marrim parasysh rrethanat historike të nëpërkëmbjes së shoqërisë sonë do të rezultoi me një nxitje dhe veprim më të madh në realizimin e këtyre objektivave edhe para kësaj kohe, në një interval 5-7 vite. Si shembull të veprimit në këtë drejtim duhet ta marrim Izraelin, i cili ka investuar jashtëzakonisht shumë në sigurinë dhe industrinë respektive, duke a marrë fatin e vet në dorë tij, por me ndihmën e madhe Amerikane. Shpresojmë që e njëjta përkrahje dhe vetëdijësim për investim në sigurinë dhe stabilitetin vetanak, të ndodhë edhe me rastin e Kosovës.

Motoja e mospërzjerjes së politikanëve në çështje ushtarake, përpos në misionin në shërbim të qytetarëve dhe mbikëqyrjes së kompetencave të saja në përputhje me Kushtetutën, duhet të jetë imperativ.

Furnizimi vetëm me pajisje ushtarake amerikane është një çështje që nuk vihet në diskutim. Kjo situatë duhet të na rikujtojë edhe një veprim që Qeveria e Kosovës duhet ta ndërmarrë menjëherë, heqjen e doganës për të gjitha produktet e prodhuara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si një çështje më e vogël që mund të bëhet duke e marrë parasysh reciprocitetin e 0 % doganë që produktet e Kosovës kanë me hyrjen në tregun amerikan, si dhe në shenjë falënderimi për përkrahjen e jashtëzakonshme për çlirimin, pavarësinë dhe sendërtimin e shtetësisë së Kosovës.

Krijimi i ushtrisë së Kosovës përmbyll procesin e vetëm të mbetur të pavarësimin të Kosovës, ofron sigurinë e domosdoshme për shtetasit e saj dhe krijon një perspektivë të ngritjes së sigurisë dhe stabilitetit në Evropën Juglindore dhe më gjerë.

Urime për ushtrinë e Kosovës, lavdi dëshmorëve!

Cavusoglu: ShBA-ja po punon për ekstradimin e Gulenit

ANKARA, 16 DHJETOR - Ministri i Jashtëm i Turqisë thotë se presidenti amerikan Donald Trump kohët e fundit e siguroi presidentin turk Rexhep Tajip Erdogan se Uashingtoni po konsideron ekstradimin e një kleriku mysliman që Ankaraja e

akuzon për orkestrimin e një grushti ushtarak të dështuar në vitin 2016.

Ministri i Jashtëm turk Mevlut Cavusoglu i tha rrjetit televiziv amerikan CNBC se kur presidentët Trump dhe Erdogan u takuan kohët e fundit në

Samitin e G-20 në Argentinë, udhëheqësi amerikan tha se Shtetet e Bashkuara po punojnë për ekstradimin e Fetullah Gulenit dhe njerëzve të tjerë.


Gulenit, 77-vjeçar, një aleat i dikurshëm i Erdoganit, ka jetuar në mërgim të vetëvendosur

në shtetin lindor të Pensilvanisë për gati dy dekada, por Uashingtoni i është kundërvënë kërkesës së Erdoganit për ta ekstraduar për t'u përballur me akuzat se ai drejtoi përpjekjen e grushtit të shtetit nga përtej Atlantikut.



May akuzon Blairin se po minon bisedimet për marrëveshjen Brexit

May i quajti komentet e Blairit ofendim për zyrën që kishte drejtuar në të shkuarën dhe tha se deputetët nuk mund të heqin dorë nga përgjegjësia duke u dorëzuar para BE-së për Brexit me zhvillimin e një referendumit të ri



LONDËR, 16 DHJETOR - Theresa May ka sulmuar një prej paraardhësve të saj, ish-liderin laburist Tony Blair, duke e akuzuar se po "minon" bisedimet për Brexitin, duke bërë thirrje për një referendum tjetër në vend. May i quajti komentet e Blairit ofendim për zyrën që kishte drejtuar në të shkuarën dhe tha se deputetët nuk mund të heqin dorë nga përgjegjësia duke u dorëzuar para BE-së për Brexit me zhvillimin e një referendumit të ri.

"Që Tony Blair të shkojë në Bruksel dhe të kërkojë t'i minojë negociatat tona duke advokuar për një referendum të dytë, është një ofendim për zyrën që ka mbajtur dikur dhe për njerëzit që ai dikur u ka shërbyer. Ne nuk mundemi, si ai, të heqim dorë

nga përgjegjësia për këtë vendim. Parlamenti ka një detyrë demokratike për të ofruar atë që votuan britanikët", tha May.

Në Londër javën e kaluar, Blair tha se deputetët mund të mbështesin një votim të ri nëse "asnjë nga opsionet e tjera nuk funksionon". Duke iu referuar një përplasje të mundshme me May, ai këmbënguli që një referendum i ri do të ishte demokratik. "Larg nga të qenit antidemokratik, do të ishte e kundërta, pasi me të vërtetë shumë figura të larta në partinë e saj nga e kaluara dhe të tashmen e kanë pranuar se duhet", tha ai. Të enjten rreth 10 deputetë të Partisë Laburiste takuan David Lidington, i cili është de facto zëvendësuesi i komanduar i Mayt, për të argumentuar për një

votim tjetër publik. Burimet e afërta me Lidington thanë për BBC-në se ai nuk ishte "duke planifikuar ose mbrojtur idenë për një referendum të dytë". Shumë figura të larta të laburistëve janë thellësisht të shqetësuar për miratimin e një referendumit tjetër. Qeveria, po

ashtu, është kundër çdo referendumi të mëtejshëm, duke thënë se publiku bëri një zgjedhje të qartë kur votuan në vitin 2016 për t'u larguar me një diferencë prej 51.9% pro ndaj 48.1% kundër. Ndërkohë, shefi i stafit të kryeministres, Gavin Barwell, u është

përgjigjur raportimit të "Daily Mail" të dielën, ku thuhet se ai u kishte kërkuar kolegëve një referendum tjetër si e vetmja rrugëdalje nga ngërçi ku është futur Brexitin, duke sqaruar se nuk po planifikoj një referendum tjetër me kundërshtarët politikë, duke iu referuar Blairit.

Koreja Veriore dënon sanksionet nga Shtetet e Bashkuara

PJONG JANG, 16 DHJETOR - Koreja Veriore të dielën ka dënuar ngritjen e sanksioneve nga administrata e Shteteve të Bashkuara, duke kërkuar të shkëmbim zjarresh dhe bllokim të



qytetit Pyongyang. Reagimi i Koresë Veriore vjen pas deklaratave të SHBA-së se ka ngritur sanksionet ndaj tre zyrtarëve, duke përfshirë një ndihmës kryesor të liderit Korean Kim Jong Un për shkak të abuzimit me të drejta të njeriut. Denuklearizimi i Koresë Veriore ka shënuar progres shumë të vogël që nga takimi në Singapor i dy liderëve, Kim Jong Un dhe Donald Trump. Të dyja palët

duhet ta caktojnë takimin e ri të punës që u anulua në nëntor.

Ministria e Jashtme koreane tha në një njoftim se Uashingtoni ka ngritur sanksionet për më shumë se tetë herë ndaj kom-

panive, individëve, anijeve, jo vetëm të Koresë, por edhe të Rusisë, Kinës dhe palëve të tjera të treta.

Nëse administrata amerikane beson se ngritja e sanksioneve dhe presionit, detyron Pjongjangun të tërhiqet nga armët bërthamore "do të ishte llogaritja më e dobët dhe do të bllokonte denuklearizimin e Gadishullit Korean përgjithmonë", thuhet në njoftimin e ministrisë.

Sërish protesta në Paris

Paris, 16 dhjetor - Protestuesit me jelekë të verdhë po bllokojnë dhjetëra pika të trafikut në Francë, edhe pse lëvizja e reformës ekonomike duket se e ka humbur vrullin në fundjavën e pestë të demonstratave. Disa francezë vazhduan të dielën të protestojnë me gjithë një thirrje nga ministri i Brendshëm Christophe Castaner për t'i liruar rrugët.

Tetë vetë kanë vdekur në incidente të lidhura me lëvizjen e "Jelekëve të verdhë", kryesisht nga aksidentet e trafikut në rrugët e bllokuara nga protestuesit. Të shtunën, protestuesit dolën në rrugë në qytete anembanë Francës, duke përf-



shirë edhe Parisin, por në numër shumë më të vogël se fundjavat e mëparshme. Protestat filluan në nëntor kundrejt rritjes së taksave të karburantit, por janë shndërruar në një shprehje të përgjithshme të zemërimit në qeverinë e presidentit Emanuel Macron.

Ministri i Jashtëm i Maqedonisë, agjent i CIA-s?

SHKUP, 16 DHJETOR - Nikolla Dimitrov, ministri i Jashtëm i Maqedonisë rezultoi të jetë agjent i CIA-s amerikane. Ky është konkluzioni që nxjerrin mediet e shtetit fqinj duke iu referuar dokumenteve të pub-

likuara nga Wikileaks. Sipas këtyre dokumenteve, të cilave nuk u është identifikuar ende autenticiteti, Dimitrov ka qenë operativ i fshehtë i CIA-s, që ka spiunuar ish-kryeministrin Nikolla

Gruevski dhe ish-presidentin Branko Crvenkovski në vitin 2008.

Në atë kohë po zhvillohej procesi i zgjidhjes së problemit të emrit me Greqinë dhe Dimitrov, sipas Wikileaks,

është evidentuar si burim i mbrojtur i Ambasadës amerikane.

As ministri Dimitrov, ashtu edhe autoritetet amerikane nuk kanë reaguar ende për lajmin e shpërndarë.



Greta Garbo, historia e dashurisë me kostumografen e njohur

Greta Garbo nuk ishte vetëm aktorja e adhuruar nga meshkujt. Në jetën e saj shpesh të vetmuar, ajo pati tërheqje dhe nga femrat. Mercedes de Acosta është një prej tyre. Poetja dhe kostumografa spanjolle-amerikane është e njohur për historitë e saj të dashurisë me aktore të njohura si Marlene Dietrich, Eleonora Duse, Isadora Duncan. Por biografët shkruajnë se gruaja që ajo deshi më shumë ishte Garbo.

Shumë gazetarë apo biografë kanë pritur prej kohësh për letrat e dashurisë mes Garbos dhe Mercedes, por publikimi i tyre kohë më parë, do ti zhgënjente, pasi ishte e vështirë të shihje shenja lesbizmi. Megjithatë shumë besojnë se lidhja mes tyre ishte një histori dashurie. Ato u takuan në vitin 1931 dhe De Acosta u fiksua shpejt pas Garbos. Një obsesion që vazhdoi deri në fund të viteve 1960, kur De Acosta publikoi kujtimet e saj dhe shkroi shumë faqe të tëra për



Garbon.

Marrëdhënia e saj me Garbo-n shpesh është përshkruar si dashuria e jetës së saj. Të dyja kanë ndenjur bashkë në periudha të gjata gjatë jetës, duke bërë pushime në vende të ndryshme. Por e gjithë kjo histori sërish ngjall dyshime për kritikët. Në vitin 1944 thuhet se lidhja e tyre mori fund sërish. Garbo i shkruante de Acostas që të mos i dërgonte më poezi, apo letra ku i

shprehte dashurinë.

Poema e fundit, e njohur, e shkruar nga de Acosta për Garbon, u shkrua po atë vit. Por ndryshe nga Garbo, de Acosta mbeti e dashuruar me aktoren gjatë gjithë jetës së saj. Hapja e koleksionit të letrave të saj 10 vjet pas vdekjes do të nxirte në pah këtë histori. Në vitin 2000 në Muzeun Rosebach do të ekspozohej një kuti me letrat dhe shkrimet që Garbo i shkroi

De Acosta-s, nga viti 1931 deri në vitin 1960, por ishte e vështirë të gjeje në ato letra detaje që tregonin që mes tyre kishte një histori pasioni. Garbo ishte i ftohtë dhe e rezervuar në letrat e saj.

Në vitin 1960 Mercedes De Acosta ia shiti letrat për Garbon Muzeut Rosenbach, me të drejtën që, të rrinin të mbyllura 10 vjet pas vdekjes së Garbos. Kutia që përbante 88 letra, telegrame dhe

karta u hap në prill të vitit 2000, por asgjë nuk zbuloi se kishte një marrëdhënie intime mes dy grave. Garbo dhe Mercedes de Acosta takuan herën e parë në vitin 1931 dhe kaluan pushimet bashkë në Sierra Nevada. Pak vite më vonë, pasioni mes tyre nuk do të ishte aq i madh, ndoshta nga këmbëngulja e Mercedes për të genë gjithë kohës bashkë.

(gazeta-Shqip.com)



“Hiroshima dashuria ime”, historia e një filmi

– Ti nuk ke parë asgjë nga Hiroshima! Asgjë!...

Ndërsa ajo i përgjigjej:

– Unë kam parë gjithçka. Dhe spitalin e pashë. Si mund të mos e shikoja?...

– Në çfarë filmi interpretoni?

– Në një film për Paqen. Ç’mund të xhirohet tjetër në Hiroshima veçse një film për Paqen?... Ne fillim ne takoheshim në hambare dhe nëpër rrënoja, më pas nëpër dhoma e kudo. Pastaj ai u vra. Dashuria ime që u vra ishte një armik i Francës...”

Ishte një film që hapej me këpurdhën e bombës atomike të hedhur në Hiroshima, mbi të cilin fillonte dialogu i një gruaje franceze dhe i një burri japonez, shtrirë në krevatin e një hoteli. Ishte piktakimi im i parë me letërsinë e Marguerite Duras, (Dyras), përmes skenarit të filmit të njohur Hiroshima dashuria ime.

Atëherë, ky film ishte ndaluar të shfaqej në Shqipëri, por një numër i revistës L’Avant scène du cinema, që vinte atë kohë në Kinostudio bashkë me Cahiers du Cinéma dhe Anthologie du cinéma, e kishte botuar atë të ilustruar me një mori skenash nga filmi dhe aktorët e tij. Një histori pacifiste dhe kundër luftës, por që bashkonte fatet njerëzore në pika të ndryshme të globit. Një grua



franceze që vinte të luante një film në Hiroshima dhe që në rininë e saj kishte dashuruar një ushtar gjerman në qytetin e saj të lindjes. Në të njëjtën kohë vendosej paralelizmi me tragjedinë e madhe të luftës që kishte ndodhur në Hiroshima. Një klithmë kundër luftës, kur Shqipëria jetonte si “në rrethim” nga mijra bunkerë të paranojës totalitare.

Edhe pse me një frëngjishte të varfër unë e përktheva atë skenar në ca faqe të holla rozë, skenar që do të shëtiste në duart e kineastëve të rinj, të etur për të njohur filmat modernë e pacifistë dhe kundër luftës. Kundër luftës, në një vend që jetonte me luftën, alarmet, bunkerët, stërvitjet ushtarake, me idenë dhe paranojën e rrethimit... Të flisje për Hiroshimën ishte e ndaluar! Përse ti flet për Hiroshimën? Çdo të thotë Hiroshima për ty kur ne i kemi

imperialistët e revizionistët në grykë të topit?... Por ne kishim rënë në magjinë e kinemasë dhe kishim filluar të zgjoheshim, të kuptonim, të ndjenim dhe të flaknim atë topitje të trurit që kishte pushtuar pothuaj të gjithë... Hiroshima ishte një tragjedi e madhe!

– “Atë ditë, – shkruante Dyras në skenarin e saj, – ne do të takoheshim në breg të lumit të Loire-s. Do të ikja me të. Kur mbërrita në mesditë, ai ishte atje. S’kishte vdekur akoma. Dikush e kishte qëlluar nga një kopësht. Gjithë ditën qëndrova mbi trupin e tij. Po kështu dhe natën. Të nesërmen erdhën dhe e morën me një kamion. Atë natë, Nevers u çlirua... Ishte dashuria ime e parë... Pastaj një tjetër ditë klitha. Më futën në një bodrum...”

Ky skenar, për ne të rinjtë e asaj kohe ishte vërtet tronditës dhe

krejt i kundërt nga ato që shikonim në kinematografinë e Lindjes. Madje bashkë me mikun tim skenarist Nexhati Tafa dukej se ajo mënyrë shkrimi influencoi drejtpërdrejt në shkrimet tona duke përdorur reticencë, vazhdimisht tri pika, në fraza të shkurtra, apo thjesht “përplasje” imazhesh, por në fjalë. Më pas, një tjetër libër i ardhur nga një studente shqiptare në Francë më hapi një dritare të dytë mbi këtë shkrimtare: ishte romani Moderato cantabile, i cili dhe ai do të gjente ekranin e kinemasë. E megjithatë, Dyras më ishte ende një enigmë? Cila ishte kjo shkrimtare kaq e ndjeshme, e dhimbshme, lakonike, me një gjuhë që depërtonte thellë në humnerën e shpirtit njerëzor dhe shpesh të trondiste? Nga vinte dhe cila ishte bota e saj?... Shumë vite më vonë lexova librin e saj Dhimbja, La Douleur, dhe kuptova vërtetshkatërrimin e madh që kishte lënë në psikikën e saj lufta,

lufta ku ajo ishte një pjestare e Rezistencës franceze dhe që kishte përjetuar përndjekjen, Gestapo-n, dhe dhimbjen e madhe kur nga kampi i përqëndrimit do të kthehej më së fundi në Francën e lirë burri i saj, Robert Antelme: “Vallë ishte ai?” – do të shkruante ajo në librin e saj: “Dëgjova thirrje që vinin nga shkallët, këmbë që ngjiteshin, kërkëllitja e portave. Ishin ata që vinin nga Gjermania... E mbanin nga krahët. U ndalën në katin e parë. Ai kishte ngritur sytë... Nuk di se ç’ndodhi. Duhet të më ketë njohur dhe të më ketë buzëqeshur. Klitha se nuk mund ta shihja ashtu. Gjithë vitet e luftës më shfaqeshin përmes atyre klithjeve të mia. Gjashtë vjet pa klithur. U gjeta tek fqinjët. Ata më detyronin të pija rum, ma derdhnin në gojë. Përmes thirrjeve. Nuk e di se kur u gjeta përpara tij...”

(Luan Rama/gazeta-Shqip.com)



DRITA E AMERIKËS NË KOSOVË



Ismet SYLEJMANI

Drita është personazh i madh i US ARMY në Kosovë! Aja rreshtohet bashkë me një numër nga Amerika me prejardhje shiptare që kanë dhënë kontributin e tyre në ndërtimin i paqes dhe konsolidimin e shtetit të Kosovës! Drita është përfaqësuesja më në zë e US ARMY në Kosovë!

Përfundimi i luftës në Kosovë dhe hyrja e trupave të NATOS e ka gjetur Dritën pranë ushtarëve, komandantëve e gjeneralëve të lavdishëm amerikan!

Drita është shqiptaro-amerikanja që ka marrë pjesë në çdo eveniment relevant në Kosovën e pasluftës!

Drita erdhi si përkthyesja e Komandantëve dhe përfundoi si këshilltarja e lartë e politikës Amerikane të shume Gjeneraleve në Camp Bondsteel në Kosovë!

Drita është ajo që ka dhënë kontribut në konsolidimin dhe funksionimin e Kosovës së pas luftës së UÇK-së!

Drita ishte artikulluesja e madhe dhe e vetme, ajo që ka ndërmjetësuar në mes Komandantit të Campit Bondsteel dhe Institucioneve ushtarako-politike e popullit shqiptar të Kosovës për më shumë se një dekadë ku sherbeu më me shumë se 20 Gjeneral American si antare Civile pjesë e Grupit të udhëqjes më lartë të US ARMY që erdhi me NATO-n aja vetë si Amerikane me gjak shqiptare -Malsore.

Me krenari vazhdon me jetu dhe me punu në Kosovë në fushën e sigurisë si vazhdimësi e

konsolidimit shtetit tonë!

Roli i madh dhe i pazëvendësueshem i Dritës në Kosovë, është historik dhe do të mbetet përgjithmonë në memorien e popullit shqiptar!

Drita është femra e madhe dhe e vetme që ia ka kushtuar afer 20 vite të jetës së saj shtetit të vet Amerikës dhe njëkohësisht popullit të Kosovës.

Drita është ëmblema e shqiptaro-amerikanës në Kosovë! Është rast i rrallë dhe ka për të mbetur i tillë, që një femer shqiptaro-amerikane ushqen një dashuri të pakufishme për babain e sajë i cili edhe pse nuk jeton më, amanetin vazhdon me ja qu në vend!

Drita nuk i pranon por ka merita të mëdha dhe të veçanta të krijimit të KOSOVA ARMY!

Ashtu sikur Drita që ka dhanë kontributin e saj në themelimin e USHTRISË SË KOSOVËS, ka edhe shumë shtetas amerikan me prejardhje shqiptare që kanë kontribuar dhe të cilët i përshendesim dhe e çmojmë lartë kontributin e tyre!

Prandaj me rastin e krijimit të USHTRISË SË KOSOVËS kam knaqesinë dhe nderin e madh që si ish - Anëtarë i Shtabit e ish - zëdhënës i Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së dhe Zonës se 6-të të TMK-se ku edhe e njof-ta Dritën para 20 viteve, t'i shpreh falenderimet e mia dhe të popullit shqiptar të Kosovës, kësaj shqiptaro-amerikaneje të madhe, e cila ka dhënë dhe ka bërë shumë për Kosovën në veçanti dhe popullin shqiptar në përgjithësi!


Faleminderit Drita!

Përgjithmonë të jemi mirënjohës!

Jemi me fat që të kemi në mesin tonë!

Shëndet e suksese Drita e madhe, Ti shqiptaro-amerikanja e lavdishme!

Prishtinë, 15 Dhjetor 2018



Drita Perezic, është e lindur në 1971, shtëpia e saj në Amerike është në New York!

Ka dy femijë vajzën Zana Marijen dhe djalin Alexanderi!





Autor: GAZMEND MORINA		QË BESON VERBËRISHT NË DOGMËN FETARE	ZBËRTHIM I NJË ÇËSHTJE	PIJE FRESKUESE E ATHËT (sh.shq.)	SOLIST-JA ... BYTYQI	SPIUNIA E FAMSHME ... HARI	EPOKA ERE	NDESH	ANTON PASHKU	KOMANDANT I NJË ANIJEJE	SFOND SHKRONJASH	FAREFISI (bised.)
LUTEM (fet.)							HEROI ZEJNULLAHU					
SHPIRTI (Lat.)							PANDJESI I PËRQESHUR					
PËSHPËRIT FJALË MAGJIKE								PRAPA KRUJA, APOLONIA				
PËRGJIGJE NË TELEFON					AGIM TEJECI AZEM BEJTA			SHTET NË AMERIKË FALJE QË BËJNË DISA HERË NË DITË MYSLIMANËT				
KËNGËTARJA ... TARNER						RROGA VJETORE E PAPËS ELIZA DUSHKU						SHKENCA QË STUDION METODAT DHE MJETET E HETIMIT E TË ZBULIMIT TË KRIMEVE
AKTORJA E FAMSHME ITALIANE ROSSELLINI (shqip.)								"E" para dy "K" HYJNI E DASHURISË (mit. romake)				
MUZIKANTI AMERIKAN ... ROCK					RE E DENDUR TYMI SHUMË E GJATË							BASHKËT. UDHËHEQËSI I NJË PARTI POLITIKE
EPOKA ERE	KËNGËTARJA AMERIKANË NË FOTO	JONI ME NGARKESË NEGATIVE	NËNREPART USHTARAK I PËRBËRË PREJ DISA TOGASH	ENË PËR TË NXJERRË UJË NGA BUNARI (shq.) FUTBOLLIST PORTUGEZ	IGLI TARE	"A" në mes të dy "M" PJESE E FORTE E BUKËS (sh.shq.)	KORNIZË VËNIA E MINAVE			BRUS ... TATUAZH (bised.)		
QË SHPREHET ME PAK FJALË E NË MËNYRË TË PRERË						KAMION I VOGËL QË KA TË BËJË ME FSHATINË, FSHATARESKE		FJALË E DHËNË PËR DIÇKA KANAPE E GJERË DHE E GJATË				
PËRTËRITËS							RIDERS (shk.) MARK ANTONI			KËNGËTARJA ROZANA ... ZANORE		
PORT DETAR					SHTET NË EVROPE MJET UDHËTIMI E TRANSPORTI (shq.)					NGJYRË E FYTYRËS NOTE MUZIKORE		
KING OF PRUSSIA			PËRSËRITËS (gram.) PJESE E EPËRME E DHOMËS							ILUZIONISTI SHQIPTAR NADIR ... RENS ISTVUD		
MËRI, ZILI				REOMIR, TANTAL SHKRIMTARI HAZIRI (shq.)			AKTORI EGJIPTIAN SHARIF (shq.) LLOJ I LETËRSISË EPIKE			IRMA LIBOHOVA ROBERT REDFORD		
KULLË E XHAMISË						DIKTATUR RUS				RAVENA DUKAT		ZANORE BOSHT
JAM I DENJË TË NDEROHEM E VLEJ TË MË JEPET NJË ÇMIM A NJË SHPËRBLIM	FUTBOLLISTI KROAT KLASNIÇ PARIA E SHOQËRISË					EPOSI VEPRIMTARI I SHQUAR PETRO ... LUARASI		MJET PUNE (shq.)	REKUIZITË SPORTIVE (shq.)	NËPËR ARA, ARAVE PËREMËR VETOR		
BASHKË, TOK (bised.)			"ASHTU QOFTË" KALIBËR I TYTËS SË ARMËS			QË NXË NJË OKË (PËR ENËT) BËRTHAMOR						KASTRIOT TUSHA SPORT LUFTARAK
SHKRIMTARJA KADARE					I BËJ APEL ZANORE					KNOWLEDGE SYSTEMS INSTITUTE NJËSI PESHE PËR GURËT E ÇMUAR		
RITUAL				SHKRIMTARI ALIGIERI LËNDË MËSIMORE				PERIUDHË E GJATË DHE E RËNDËSISHME HISTORIKE VENDËS, RRËNJËS				BASHKËT. NDËRRIM I MALLIT
VENDLINDJA E ODISEUT					DY ZANORE ISLANDA		KALI I STËRVITUR MA JEP			KËNGËTARJA BAJRAMI ANNAPOLIS PERFORMANC E SAILING		
KRYEQYTETI I ESTONISË						HUQ, VES VARIOLË			BUJK BASHKËT.			TEDI ALVES
OSAKA		NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE ZANORE			SUPER MODELJA ADRIANA BASHKËT.			ARMË E FTOHTË PREJ ÇELIKU (sh.shq.) ONTARIO				
RILINDËSI ... VRETO				PIKTORI PABLO						EMBLEMA		

E jashtëzakonshme

Kapen 3.2 tonë brirë elefantësh që po kontrabando-heshin me anije

Kamboxia ka kapur më shumë se 3.2 tonë brirë elefantësh të fshehura në një magazinë. Një zyrtar i doganave ka bërë me dije se brirët ishin dërguar nga Mozambiku. Ai ka shtuar se kjo ishte sasia më e madhe e materialit të fildishtë në vend.



FOTO E DITES



Fëmijët shikojnë nga një dritare, të mbuluar me një najlon plastik për t'u mbrojtur nga të ftohtit në Indi. /Reuters/

E rrallë

Zbulohet në Kanada diamanti i verdhë 552 karat

Një diamant i verdhë 552 karat është zbuluar. Ai konsiderohet diamanti më i madh i gjetur ndonjëherë në Amerikën e Veriut. Kompania

minerare "Dominion Diamond Mines" ka njoftuar se diamanti u zbulua në tetor në Diavik Diamond Mine, në territoret e Amerikës

Veriperëndimore. "Guri i çmuar i mahnitshëm ka përmasat 33.74 milimetra me 54.56 milimetra", ka njoftuar kompania.



BARSOLETA E DITËS



Gruaja: Dua që ti të jesh i ndershëm me mua. **Më ke tradhtuar me tjetër?**
Burri: Jo ty, tjetrën!




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

"ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

"JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

"NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

"SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

"VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Sot çdo gjë duket sikur shkon sipas planit dhe nuk

do të ndiheni të rrezikuar aspak nga një koleg që ju ka vënë shkopinj nën rrota.



DEMI

Mjaft aktivitete dhe surpriza të këndshme

parashikohen për të lindurit e kësaj shenje gjatë kësaj dite. Do të jeni të rrethuar nga dashuria.



BINJAKËT

Një ditë plot ngjyra ashtu siç

ndiheni edhe ju sot. Kudo që jeni me familjen apo me miqtë, çdo gjë do të shkojë shumë mirë.



GAFORRJA

Sot keni nevojë për përkëdhelje dhe pak

intimitet me partnerin, por nuk do ta realizoni dot. Të afërmit tuaj ju kanë zbarkuar në derë.



LUANI

Keni mjaft opsione interesante sot për ta

kaluar ditën dhe nuk dini kë të zgjidhni. Miqtë duan një ditë në natyrë dhe vendi do t'ju pëlqejë pa masë.



VIRGJËRESHA

Ilaçi i ditës tuaj sot do të jenë blerjet.

Ata që ju shoqërojnë do të kënaqen sepse ju bëni shumë dhurata.



PESHORJA

Sot jeni ju protagonistët e situatave të

ndryshme që jua ofron dita. Do të dini të bëni zgjedhjet e duhura.



AKREPI

Edhe pse dita do të jetë shumë e rrëmujshme,

mbrëmja paraqitet e qetë dhe në shoqëri të mirë.



SHIGJETARI

Partneri nuk do të kuptojë një

takim punë që do t'ju dalë sot papritur. Debate dhe zënka parashikohen gjatë pasdites.



BRICJAPI

Keqkuptimet që do të lindin së

fundmi nuk do të ndodhin për shkakun tuaj, kështu që nuk keni pse të ndiheni fajtor.



UJORI

Mos qëndroni të mbyllur në shtëpi sot.

Dita është shumë e bukur dhe duhet shijuar në çdo moment. Do ta kërkonte shoqërinë e një miku.



PESHQIT

Nervozizmi që do të keni sot

përgjatë gjithë ditës nuk do t'ju lejojë të shijoni këtë ditë pushimi që vetëm stresante nuk duhej të ishte.

Marrëdhënia e Davidit dhe Victoria Beckhamit në krizë. Rita Ora mes tyre?



Marrëdhënia e Davidit dhe Victoria Beckhamit është përfolur gjithmonë dhe ata janë lakuar si një çift i përkryer. Por duket se jo çdo gjë po shkon mirë. Çifti Beckham është duke kaluar një krizë në marrëdhënien e tyre. Në mbrëmjen "The British Fashion Awards" ata kanë qën-

druar larg njëri-tjetrit dhe nuk kanë shkëmbyer asnjë fjalë, shkruan "blitz.al". Davidi gjatë kësaj mbrëmje është parë shumë i afërt me këngëtare me origjinë shqiptare Rita Orën. Ata kanë biseduar gjatë dhe nuk kanë munguar as të qeshurat, por a mund të jetë Rita pjesë e krizës së çiftit?

Hilary Duff takon fëmijët me babadimrin



Aktroja Hilary Duff u fotografua nga paparacët teksa dërgoi fëmijët e vet ta vizitonin babadimrin në The

Grove të Los Anjelist. Ajo ishte së bashku me të dashurin Matthew Koma dhe dukeshin shumë të lumtur si familje.



Gigi Hadidi duket e mrekullueshme me fustanin e dizajnuar nga Valerie Messika

Modeluesja e njohur e "Victoria Secret", Gigi Hadid, edhe një herë dëshmoi se duket e mrekullueshme në veshjet e saj. Ajo së

fundi realizoi një fotografi me fustanin e dizajnuar nga francezja Valerie Messika. Ajo këtë fustan të zi që pati të veshur e shoqëroi edhe me një qafore me shkëlqim.

Remy Ma bëhet sërish nënë

Remy Ma është bërë sërish nënë. Reperja 38-vjeçare dhe bashkëshorti i saj Papoose kanë njoftuar se kanë mirëpritur në jetë një vajzë. "Faleminderit Papoose që më kë bërë gruan më të lumtur në botë!", ka shkruar Remy në rrjetet sociale. Remy ka një djalë me emrin Jayson, nga një marrëdhënie e mëparshme, ndërkaq Papoose ka tre fëmijë prej lidhjeve të mëparshme. Remy dhe



Papoose fillimisht zbuluan se po presin fëmijë në korrik. Çifti u martua 10 vjet më parë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ALAVES - ATHLETIC BILBAO

GG

FC KOLN V MAGDEBURG

1&3+

MIEDZ LEGNICA - LECHIA GDANSK

2

Osmani: Vushtrria rikthehet në Superligë



Autori i 12 golave në sezonin vjeshtor, Labinot Osmani, beson se skuadra e Vushtrrisë do ta mbajë pozitën e parë deri në fund të kampionatit dhe të rikthehet në Superligë. "Mendoj se jemi shpallur kampionë vjeshtorë me shumë mund dhe besoj se ka qenë një punë e vështirë dhe e mundimshme deri këtu, por rezultatet kanë qenë të merituar. Nëse vazhdojmë me këtë formë dhe nëse klubi bën dy përforcime, besoj shumë në inkuadrimit në Superligë", ka thënë Osmani

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Skuadra e Vushtrrisë ka treguar një sezon shumë të mirë në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. Kjo skuadër u rendit e para pas përfundimit të sezonit vjeshtor, duke lënë pas vetes skuadra të njohura si Besa, Dukagjini, Vitia dhe Vëllaznimi. Kapiteni i Vushtrrisë, Labinot Osmani, të dielën për "Epokën e re" ka thënë se rrugëtimi drejt një suksesi të tillë ka qenë i vështirë, por rezultatet kanë qenë plotësisht të merituar. Sulmuesi i dëshmuar në futbollin e Kosovës, i cili ka realizuar 12 gola, beson se nëse klubi përforcimet me dy lojtarë, atëherë inkuadrimit në Superligë do të ndodhë. "Mendoj se jemi shpallur kampi-

onë vjeshtorë me shumë mund dhe besoj se ka qenë një punë e vështirë dhe e mundimshme deri këtu, por rezultatet kanë qenë të merituar. Nëse vazhdojmë me këtë formë dhe nëse klubi bën dy përforcime, besoj shumë në inkuadrimit në Superligë", ka thënë Osmani, i cili ka folur edhe për skuadrat e tjera që kanë gjasa më të mëdha për t'u inkuadruar në rangun më të lartë në futboll. "Ne jemi konkurrentë së bashku me Besën, Vëllaznimin, Dukagjinin dhe ndonjë skuadër tjetër", ka shtuar ai.

Labinot Osmani ka folur edhe për edicionin e kaluar, kur skuadra e Vushtrrisë luajti në barazh por, pas penalltive, mbeti sërish në Ligën e Parë. Sipas tij, Vushtrria me pak fat ka mundur të ishte pjesë e Superligës. "Vitin e kaluar kemi treguar

shumë lojërë të mira dhe mendoj se me pak fat kemi mundur të jemi pjesë e Superligës por, siç e dini, në barazh penalltive kanë vendosur fatin tonë që edhe këtë edicion të bëjmë gara në Ligën e Parë", ka shtuar Osmani.

Sulmuesi i Vushtrrisë ka një karrierë të pasur futbollistike dhe, si për coincidence, tri ish-skuadrat e tij janë duke luftuar për titull në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. "Mendoj se skuadrat konkurrenente për titull në Superligë do të jenë Prishtina dhe Feronikeli, kurse Llapi do t'i presë gabimet e dy skuadrave të para. Do të jetë një kampionat interesant ashtu sikurse edicionin e kaluar", ka përfunduar Osmani.

Skuadra e Vushtrrisë e përfundoi sezonin vjeshtor me 38 pikë, tri më shumë se Besa e Pejës.

SHKURT

Dy asistimet e Zenelit nuk i mjaftojnë Heerenveenit

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Arber Zeneli, ka asistuar në dy golat që i shënoi skuadra e tij, Heerenveen, në ndeshjen ndaj FC Utrecht, por kjo ishte e pamjaftueshme për faktin se fitore shënuan mysafirët (2-3). Golat nga asistimet e Zenelit i shënuan Michel Vlap dhe Pelle Van Amersfoort.

Dështon transferimi i Berishës te Llapi

Skuadra e Llapit është dorëzuar, pasi nuk ka arritur ta transferojë mbrojtësin Visar Berisha, i cili është pjesë e skuadrës së Ballkanit. "Është dëshirë e jona që ta kemi në skuadër një futbollist si Visar Berisha, por Ballkani ka nevojë për të dhe ai do të qëndrojë aty", ka thënë Batatina për "Gazetasheshi.com".

Prishtina, Drita dhe Kastrioti e mbyllin sezonin vjeshtor me fitore

Ashtu si pritej, Prishtina e Drita i kanë fituar ndeshjet e xhiros së 14, përkatësisht xhiros së fundit të stinorit vjeshtor në Superligën e Kosovës për hendbollistë. Në kryeqytet, Prishtina e mposhti Vëllaznimin e Gjakovës me rezultat 42:27. Pas pjesës së parë rezultati ishte 24:18 në të mirë të prishtinasve. Për Prishtinën është fitorja e 12, ndërsa për Vëllaznimin humbja e tetë. Fitoren e dhjetë e ka shënuar Drita që në Gjilan fitoi ndaj Trepçës me rezultat 33:23. Pas pjesës së parë rezultati ishte 15:15. Për Trepçën ishte humbja e dhjetë. Edhe Kastrioti e ka mbyllur sezonin vjeshtor me fitoren që e arriti ndaj Zhegrës (52-34).

Një medalje e artë dhe një e argjendtë për Kosovën në Kinë

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Një medalje e artë, një e argjendtë dhe një vend i shtatë është bilanci i Kosovës në xhudo, në pjesëmarrjen në Top-Mastersit të xhudos që po mbahet në Guangzhou të Kinës. Distria Krasniqi fitoi

medaljen e artë në kategorinë deri në 48 kilogramë, Nora Gjakova (-57 kg) u stolis me të argjendtën, ndërsa Akil Gjakova (-73 kg) zuri vendin e shtatë. Në "World Masters" marrin pjesë 16 xhudistët më të mirë të renditjes

botërore në kategori. Distria shënoi katër fitore, kurse në finale mundi medalisten e bronzit olimpike, Ami Kondo, me Ippon. Nora në finale u mund nga japonezja Tsukasa Joshida, kurse fitoi tri luftëra të tjera. Akili fitoi

një luftë dhe më pas u ndal në çerekfinale dhe repesazh. Gara ishte e vlefshme edhe për pikë kualifikuese për Lojërat Olimpike Tokyo 2020. Distria fitoi 1800 pikë, Nora 1260, ndërsa Akili 468 pikë.



Messi, gati të rikthehet në kombëtare

BONUES AIRES, 16 DHJETOR - Sipas televizionit argjentinas, "TN", ylli i Barcelonës, Lionel Messi, i ka shprehur Federatës së Futbollit të Argjentinës dëshirën për t'u kthyer në skuadrën e Kombëtares argjentinase para

turneut të Kupës së Amerikës, që zhvillohet në Brazil në vitin 2019. 31-vjeçari ka luajtur për herë të fundit për Kombëtaren e Argjentinës në ndeshjet e turneut të Kupës së Botës në Rusi dhe do të mungojë edhe në

ndeshjet miqësore të këtij muaji. Besohet se Messi e synon Kupën e Amerikës me Argjentinën dhe në asnjë mënyrë nuk dëshiron të largohet nga kombëtarja në mënyrë zhgënjyese, pas dështimit në "Rusi 2018".



Ronaldo: Për trofe erdha te Juventus

TORINO, 16 DHJETOR - Cristiano Ronaldo është "juventizuar" në maksimum sepse, ndryshe nga e kaluara, tashmë ai është gati të mendojë mbi të gjitha për skuadrën dhe ndoshta "stili Juventus" e ka përfshirë menjëherë edhe heroin e derbit të Torinos, i cili vendosi sfidën e parë të qytetit me një penallti. Për portugezin ishte goli i 11-të në kampionat dhe i 12-ti sezonal, duke u konfirmuar goleadori më i mirë i Serisë A bashkë me Piatekun e Genoas deri në këtë moment, por edhe golashënuesi më i mirë i bardhezinjve. "Jam shumë i lumtur për fitoren dhe golin e parë në derbi, pasi ishte një ndeshje tepër e vështirë. Fusha nuk na ndihmonte aspak, ishte skandalozë, topi kërcente shumë keq edhe për faj të të ftohtit dhe lojës së ashpër që u luajt. Gjithsesi, edhe një herë tjetër u treguam shumë të zotët, të duruar dhe e shfrytëzuam menjëherë rastin që na u dha për ta 'thyer' ndeshjen", ka thënë 33-vjeçari, i cili vë Juventusin përpara golit jubilar. "Goli numër 5 000 në historinë e Juves në Serinë A? Qëkur vendosa të vija këtu e thashë dhe e kam konfirmuar edhe së fundmi: jam këtu për ta ndihmuar



skuadrën, për ta çuar Juventusin te fitoret dhe trofetë që kërkon, së bashku me ndihmën e shokëve të mi. Sigurisht të realizosh një gol jubilar apo qoftë edhe vetëm golin që vendosi një sfidë kaq të ndërjer sa derbi, më lumturon, por unë preferoj të fitoj me Juventusin kundrejt numrave të mi", ka deklaruar Ronaldo.

Në fund, në lidhje me përplasjen me portierin Ikazo, të cilin

kërkoj ta "fërkojë" me trup pas goditjes së penalltisë, por në mënyrë miqësore, Cristiano Ronaldo shpjegon: "Ikazo u tregua shumë i zoti, por unë e godita shumë fort topin dhe ai hyri në rrjetë. E rëndësishme është që shënuam, pavarësisht prekjës së bërë prej tij. Fërkimi me të? Ishte një mënyrë për ta komplimentuar, por e sqaruam pas fare pak sekondash dhe gjithçka mbaroi aty".

Fitojnë lakersat, shkëlqen LeBron

CHARLOTTE, 16 DHJETOR - Lakersat ngjiten në vendin e katërt të renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores 128-100 ndaj Charlottes, ndeshje e luajtur në fushën e kësaj të fundit. Një takim i dominuar nga ekipi kalifornian, që kishte si protagonist të zakonshëm LeBron James, autor i një "triple double", me 24 pikë, 12 rebounde e 11 asistime. Por arma kryesore e ekipit të Lakersit ishte kolektiviteti, me 7 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë. Jashtë fushe fiton edhe skuadra e Chicagos, që mundi 98-93 San Antonion, një rezultat disi surprizë, pasi Bullas ndodhet në vendin e fundit në Lindje, me shumë probleme këtë sezon. San Antonio e udhëhoqi gjatë gjithë kohës ndeshjen, madje u shkëput deri në 20 pikë, por miqtë rikuperuan në pesë minutat e fundit, duke arritur një fitore të pabesueshme. Aldridge me 29 pikë e 12 rebounde ishte më i miri për Spursin, por që s'mjaf-tuan për ta evituar humbjen, ndërsa për Chicago u dalluan



Dunn me 24 pikë e Markkanen me 23. Në ndeshjet e tjetër, skuadra e Oklahomës mundi 110-104 Clippers, një përballje mes dy ekipeve pretendente në Perëndim. Një ndeshje në përgjithësi e dominuar nga skuadra e Thunderit, me Georgen që realizoi 33 pikë. Ekipi i Detroitit mundi 113-104 Bostonin, një fitore e merituar e skuadrës vendëse, që në pjesën e dytë dominoi dhe triumfoi falë 27 pikëve të Griffinit. Fiton edhe skuadra e Houstonit, që mundi 105-97 rivalët e Memphisit,

REZULTATET

Orlando - Utah Jazz	96-89
Charlotte - Lakers	100-128
Detroit - Boston	113-104
Memphis - Houston	97-105
San Antonio - Chicago	93-98
Oklahoma - Clippers	110-104
Phoenix - Minnesota	107-99

ndeshje e komanduar nga miqtë, që patën gjithnjë kontrollin e saj e triumfuan falë 32 pikëve, 12 reboundeve e 10 asistimeve të James Hardenit.

SHKURT

Uldedaj shpallet kampion bote në WBO Jr.

Boksieri i ri shqiptar Jurgen Uldedaj u shpall Kampion Bote në kategorinë WBO Junior të boksit, pasi mposhti argjentinasin Nikolas Leandro Arganaraz, në ndeshjen e zhvilluar në sallën "Feti Borova" të Parkut Olimpik të Tiranës. Djaloshi 21-vjeçar nga Lezha zhvilloi një ndeshje të madhe përballë rivalit argjentinas, që duhet theksuar se ishte një boksier mjaft i përgatitur. Pas plot 10 raundesh, Jurgen Uldedaj u shpall fitues i ndeshjes dhe njëkohësisht kampioni i ri i botës, falë vendimit të gjyqtarëve, që i dhanë më shumë pikë djaloshtit lezhjan. Kjo ishte ndeshja e 9 e Jurgen Uldedajt në boksion profesionist, me lezhjanin që numëron po kaq fitore dhe nuk e ka provuar ende shijen e humbjes.

Xavi për 'Topin e Artë': Më vjen mirë që nuk u përsërit 2010-ta

Xavi Hernandez është rikthyer të flasë për "Topin e Artë" të cilin e fitoi Luka Modriq. Spanjollit ishte i pranishëm në një eveniment që prezantonte një prej stadiumeve të botërorit të Katarit. Ish-kapiteni i Barcelonës ka një preferencë të qartë dhe ai është Messi. "Mendoj se Modriqi e meritoi atë çmim, ndonëse kishte edhe futbollistë të tjerë. Them se duhet të ishte një francez për shkak të fitimit të Botërorit. Për mua trofeu duhet të fitohet çdo vit nga Messi, por Modriqi është fitues i ndershëm dhe më vjen mirë që e fitoi një mesfushor atë çmim, jo siç ndodhi në 2010-n", ka thënë Xavi.

Unitedi vendos ta shesë Pogban

Manchester Unitedi duket se ka vendosur ta shesë mesfushorin Paul Pogban në afatin kalimtar të janarit. E ardhmja e Pogbas në "Old Trafford" ka qenë cak i spekulimeve gjatë gjithë sezonit pas raporteve se ka pasur përplasje me trajnerin Jose Mourinho. "The Mirror" raporton se portugezi ka humbur durimin dhe ka vendosur ta largojë lojtarin, edhe pse ai kaloi te "Djajtë e Kuq" vetëm dy vjet më herët për shifër rekorde. Juventusit konsiderohet favoriti për 25-vjeçarin, me Unitedin që shpreson të arrijë marrëveshje me përfshirjen në marrëveshje të Miralem Pjaniqit ose Alex Sandros.

Allegri: Kërkova sakrificë nga lojtarët ndaj Torinos

Juventusit e fitoi derbin ndaj Torinos me golin e shënuar nga Cristiano Ronaldo nga penalltia. Trajneri Massimiliano Allegri ka bërë me dije se u kishte kërkuar lojtarëve sakrificë për këtë ndeshje. "Ishte një ndeshje e vështirë sepse luajtëm tri ditë pas Ligës së Kampionëve. Ishte një derbi ndaj një ekipi në formë. Torino ka ushtruar presion në pjesën e parë, duke na krijuar vështirësi. Në pjesën e dytë luajtëm më mirë dhe kishim disa mundësi shënimi. U kisha kërkuar lojtarëve kompaktësi dhe sakrificë për këtë ndeshje. Në pjesën e parë nuk ishim mirë për shkak të presionit të kundërshtarit, më pas ata u lodhën. Fakti që rritemi në pjesën e parë do të thotë se po rritemi fizikisht", ka thënë Allegri, i cili e komentoi edhe penalltinë e shënuar nga Ronaldo: "Nuk i shoh penalltitë, gjithsesi përgëzoj Ronaldon për golin".

Milani e dëshiron Fabregasin, gati ta shesë Calhangolun

Milani po kërkon nga Chelsea që ta përgjysmojë shumën që po kërkon për Cesc Fabregasin. Mesfushori spanjoll është shumë i tërhequr nga mundësia për të luajtur prej janarit me Milanin. Leonardo konfirmoi për "Sky Sport Italia" se po vlerësohet situata dhe se po shikohen mundësitë për transferimin e Fabregasit. Milani po tenton të paguajë vetëm katër milionë euro për mesfushorin, gjysmën e shumës prej tetë milionësh që po kërkohet nga Chelsea. Në anën tjetër, planifikohet edhe largimi i Hakan Calhanoglu gjatë verës dhe shitja e tij prej 22 milionë eurosh që do t'i balanconte gjërat për "Fair Play Financiar". Calhangolu pritet të largohet drejt Gjermanisë, ku RB Leipzig ka interesim për reprezentuesin turk.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM SHPALLJE PUBLIKE PËR QIRADHËNIE

Njësia Nr	Emri i Ndërmarrjes Shoqërore	Emërtimi i Asetit	Vendndodhja e asetit/pronës (Adresa)	Sipërfaqja m ²
Njësia 1	NSH "Liria"- Prizren	Lokali në përdheshë të Supermarketit në Bazhdarhane	Rr."Adem Jashari"-Bazhdarhane, Prizren	30 m ²
Njësia 2	NSH "Mladost Strpce	Hapësirë për Parking "DP Mladost Strpce "	Në oborr të NSh Mladost në Shtërpcë prapa Shëpisë së Mallërave	700 m ²
Njësia 3	NSH "Mladost Strpce	Objekt i NSh Mladost Strpce" në hapësirat prapa Shtëpisë së Mallërave	Në oborr të NSh Mladost në Shtërpcë prapa Shëpisë së Mallërave	15 m ²

Kushtet e përgjithshme:

- Perioda e Qiradhënies është deri në 1 vit me mundësi vazhdimi gjithashtu edhe ndërprerje për shkak të privatizimit ose çështjeve tjera relevante.
- Ofertat bëhen në mënyrë individuale për secilën njësi veç e veç.
- Ofertat duhet të dorëzohen personalisht apo në rast që dorëzohen në emër të qiramarrësit pala duhet ta ketë autorizimin e noterizuar tek noteri.
- Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur (një zarf – një ofertë për një njësi), dorëzohen në Zyrën Rajonale të Prizrenit.
- Në zarf (jashtë) duhet të specifikohet: nr i Njesisë, emri i NSh-së, Emërtimi i Asetit dhe vendndodhja e asetit.
- Në rastet e qiradhënies në vlera mbi € 1,000 mujore, para nënshkrimit të kontratës do të kërkohet nga ofertuesi fitues të sjellë garancionin bankar (jo letër zotimi nga banka) në lartësinë e kontratës.
- Për dorëzimin e ofertës duhet të përdoret **Formulari për Dorëzimin e Ofertës** i cili mund të merret në Zyrën Rajonale të AKP-së, apo të shkarkohet nga ueb-faqja: www.pak-ks.org
- Kriteri për përzgjedhjen e ofertuesit fitues të njësive përkatëse do të jetë çmimi i ofertës më të lartë.
- Ofertat do të pranohen me **24.12.2018** prej orës 10:00 – 12:00 në zarf të mbyllur për secilën njësi veç e veç.
- Zarfet do të hapen publikisht në Zyrën Rajonale të Prizrenit me datë **24.12.2018** në ora 12:15
- Ofertat përmes faksit nuk do të pranohen.
- Sipërfaqet e prezantuar më lartë janë të përafërta dhe të dhënat më të sakta me fotot e njësive si dhe informatat tjera relevante mund të merren në Zyrën Rajonale të AKP-së në Prizren.
- Të dhënat e detajuara për pronat lëndë e ofertës mund të merren në Zyrën e AKP-së në Prizren, Rruga "Pushkatarët" No 9, Prizren; në telefonin: 029-226-480 apo në email adresën: info@pak-ks.org
- Kjo shpallje përpos që do të publikohet në gazeta ditore në gjuhën shqipe dhe serbe në Kosovë do të publikohet edhe në ueb faqen zyrtare të AKP-së.
- Në cmimin e ofertës totale duhet të përfshihen të gjitha tatimet e aplikueshme në Kosovë, përfshirë edhe TVSH 18%, etj.)

Pagesa e Qiramarrjes:

Ofertuesit fitues është i obliguar që të paguaj shumat me pagesa të rregullta paraprake mujore, duke filluar me pagesën e parë të caktuar në fillimin e kësaj Kontrate të Qirasë, dhe, deri në masën që është e zbatueshme, me pagesa mujore në vijim, të caktuara në të njëjtën ditë të muajit vijues, (apo më herët në rast se data e pagesës së parë apo ndonjë pagesë tjetër mujore rastis të jetë ndonjë festë publike.

Ofertuesit fitues për toka bujqësore pagesën e qiramarrjes duhet të bëjnë pagesë totale brenda afatit pesë ditë pune pas marrjes së kontratës për tokën që është subjekt i qiradhënies.

Dispozita të përgjithshme:

Pronat e këtyre njësive të paraqitura më lartë ofrohen për dhënie me qira "ashtu siç janë" dhe "ku janë". Ofertuesit kanë përgjegjësinë të verifikojnë përshkrimin dhe kushtet e njësive/lokaleve (gjendjen faktike) dhe AKP respektivisht Autoriteti i Likuidimit i NSh-ve përkatëse do të konsiderojë se ofertuesit kanë dijeni të mjaftueshme në lidhje me pronat e ofruara për qiradhënie dhe nuk do të jenë përgjegjës për ndonjë pengim të posedimit/shfrytëzimit eventual.

Ofertuesit me ndalesë ofertimi:

- Personat fizik apo juridik të cilët kanë uzurpuar paluajtshmërinë në pronësi shoqërore, ndaj të cilëve Agjencia apo NSh -ja ka iniciuar procedurë gjyqësore për lirimin e pronës dhe kompensimin e dëmeve eventuale;
- Personat fizik dhe juridik që: (i) nuk i kanë respektuar kushtet e ndonjë kontrate të lidhur me Agjencinë ose me çfarëdo ndërmarrje që administrohet nga Agjencia (ekzistenca dhe natyra e atij mosrespektimi do të përcaktohet nga Agjencia sipas zgjedhjes së saj), (ii) kanë borxh ose gjobë të pashlyer ndaj Agjencisë ose ndonjë ndërmarrje që administrohet nga Agjencia, (iii) personat fizik ose juridik të cilët nuk kanë paguar gjobat e caktuara nga Agjencia ose që i nënshtrohen ndonjë kërkesëpadie ose kontesti (pa marrë parasysh nëse çështja e tillë është ngritur në gjykatë apo tjetërkund).

Ofertat do të pranohen me 24.12.2018 prej orës 10:00 – 12:00 në zarf të mbyllur për secilën njësi veç e veç në:

Zyra Rajonale e AKP-së në Prizren
Adresa: Rr. Pushkatarët Nr.9, (në Shatërvan) në Prizren
Tel: 029-226-480
email: info@pak-ks.org; www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

OBAVEŠTENJE JAVNI OGLAS ZA ZAKUP

Jedinica br.	Naziv društvenog preduzeća	Naziv imovine	Lokacija imovine (Adresa)	Površina m ²
Jedinica 1	DP "Liria"- Prizren	Lokal u prizemlju supermarketa u Baždarhane	Ul."Adem Jashari"-Bazhdarhane, Prizren	30 m ²
Jedinica 2	DP "Mladost Strpce	Prostor za parking "DP Mladost Strpce"	U dvorištu DP Mladost u Štrpce iza robne kuće	700m ²
Jedinica 3	DP "Mladost Strpce	Objekat DP Mladost Štrpce u prostoru iza robne kuće	U dvorištu DP Mladost u Štrpce iza robne kuće	15m ²

Opšti uslovi:

- Period zakupa je do 1 godine sa mogućnošću produženja a takođe i prestanak zbog privatizacije.
- Ponude se mogu podneti individualno za svaku jedinicu pojedinačno.
- Ponude se moraju predati lično ili u slučaju predaje u ime zakupca onda stranka mora imati ovlašćenje potvrđeno kod notara.
- Ponude treba dostaviti u zapečaćenoj koverti (jedna koverta – jedna ponuda za jednu jedinicu), dostaviti Regionalnoj kancelariji u Prizrenu.
- Na koverti (spolja) treba navesti: br Jedinice, naziv DP-a, naziv imovine i lokaciju imovine.
- U slučaju zakupa u vrednosti preko €1.000 mesečno, pre potpisivanja ugovora će se tražiti od pobjedničkog ponuđača da dostavi bankarsku garanciju (ne bankarsku obveznicu) u visini ugovora.
- Za dostavljanje ponude treba da se koristi **Obrazac za dostavljanje ponude** koji se može dobiti u Regionalnoj kancelariji KAP-a, ili preuzeti sa veb stranice: www.pak-ks.org
- Kriterijum za izbor pobjedničkog ponuđača za dotične jedinice biće ponuda sa najvećim iznosom.
- Ponude će biti primljene dana **24.12.2018** od 10:00 – 12:00 u zapečaćenoj koverti za svaku jedinicu pojedinačno.
- Koverta će se javno otvoriti u Regionalnoj kancelariji u Prizrenu dana **24.12.2018** u 12:15
- Ponude putem faksa neće biti prihvaćene.
- Gore navedene površine su približne i tačniji podaci sa slikama jedinica mogu se dobiti u Regionalnoj kancelariji KAP-a u Prizrenu.
- Detaljni podaci o imovini koja je predmet ponude mogu se dobiti u Kancelariji KAP-a u Prizrenu, Ulica "Pushkatarët" br 9, Prizren; na telefon: 029-226-480 ili imejl adresu: info@pak-ks.org
- Ovaj oglas osim što će biti objavljen u dnevnom novinama na albanskom i srpskom jeziku na Kosovu biće objavljen i na zvaničnoj veb stranici KAP-a.
- U cenu ukupne ponude treba uključiti sve primenljive poreze na Kosovu, uključujući i PDV 18%, itd

Plaćanje zakupnine:

Pobjednički ponuđač je dužan da unapred uplaćuje redovne mesečne iznose, počevši sa prvom uplatom koja je predviđena na početku ovog Ugovora o zakupu, i do mere koliko je sprovodljivo, mesečne naknadne uplate, koje su određene za isti dan narednog meseca (ili ranije ukoliko datum prve uplate ili bilo koje druge mesečne uplate pada na određeni zvanični praznik).

Opšte odredbe:

Imovina gore navedenih jedinica nude se u zakup „u stanju u kakvom jesu“ i „gde su“. Odgovornost je ponuđača da ispitaju opis i uslove jedinica/lokala (činjenično stanje) i KAP odnosno Likvidacioni organ dotičnih DP-a će smatrati da su ponuđači dovoljno upoznati sa imovinama ponuđenim u zakup i neće biti odgovorni za bilo kakvo eventualno ometanje u posedu/korišćenju.

Ponuđači sa zabranom nadmetanja:

- Fizička ili pravna lica koja su uzurpirala nepokretnu imovinu u društvenom vlasništvu, prema kojima je Agjencia ili DP pokrenulo sudski postupak za oslobađanje imovine i naknadu eventualnih šteta;
- Fizička i pravna lica koja: (i) nisu poštovala uslove bilo kakvog ugovora zaključenog sa Agencijom ili sa bilo kojim preduzećem kojim upravlja Agjencia (postojanje i prirodu takvog kršenja određuje Agjencia po sopstvenom nahođenju), (ii) imaju dug ili neplaćenu novčanu kaznu prema Agenciji ili prema određenom preduzeću kojim upravlja Agjencia, (iii) fizička ili pravna lica koja nisu platila novčane kazne određene od strane Agencije ili koja su predmet bilo kog tužbenog zahteva ili spora (bez obzira da li je to pitanje podneto u sudu ili na nekom drugom mestu

Ponude će biti primljene 24.12.2018 od 10:00 – 12:00 u zapečaćenoj koverti za svaku jedinicu pojedinačno u:

Regionalna Kancelarija KAP-a u Prizrenu
Adresa: Ul. Pushkatarët br.9, (kod Šadrvana) u Prizrenu
Tel: 029-226-480
email: info@pak-ks.org; www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM SHPALLJE PUBLIKE PËR QIRADHËNIE

Njësia Nr	Emri i Ndërmarrjes Shoqërore	Emërtimi i Asetit	Vendndodhja e asetit/pronës (Adresa)	Sipërfaqja m ²
Njësia 1	KB Prekocvi	Hangari në Prekocv	Zona kadastrale Prekocv - Novobërdë	512 m ²
Njësia 2	NBIQ "Agromorava"	Toke Bujqësore	Zona kadastrale Drobesh - Viti, parcela 56/0	536 m ²
Njësia 3	NBIQ "Agromorava"	Toke Bujqësore	Zona kadastrale Viti, parcela 2484/1	77291 m ²
Njësia 4	NHNI "Morava e Binçës"	Toke Bujqësore	Zona Kadastrale Stanishor - Novobërdë, parcela 1152/0	7516 m ²
Njësia 5	MZT "Fam"	Objekti punues (Pajisjet dhe Arkiva duhet të mbeten në ndërmarrje)	Zona Kadastrale Viti	2500 m ²
Njësia 6	NSH "Qëndresa"	Lokali në Kamenicë	Zona Kadastrale Kamenicë	260 m ²

Kushtet e përgjithshme:

1. Periudha e Qiradhënies është për 1 vit me mundësi vazhdimi gjithashtu edhe ndërprerje për shkaqe të privatizimit.
2. Ofertat mund të bëhen në mënyrë individuale për secilën njësi veç e veç.
3. Ofertat duhet të dorëzohen personalisht apo në rast që dorëzohen në emër të qiramarrësit pala duhet ta ketë autorizimin e noterizuar tek noteri.
4. Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur (një zarf – një ofertë për një njësi), dorëzohen në Zyrën Rajonale të Gjilanit.
5. Në zarf (jashtë) duhet të specifikohet: nr i Njesisë, emri i NSH-së, Emërtimi i Asetit dhe vendndodhja e asetit.
6. Në rastet e qiradhënies në vlera mbi € 1,000 mujore, para nënshkrimit të kontratës do të kërkohet nga ofertuesi fitues të sjellë garancionin bankar (jo letër zotimi nga banka) në lartësinë e kontratës.
7. Për dorëzimin e ofertës duhet të përdoret **Formulari për Dorëzimin e Ofertës** i cili mund të merret në Zyrën Rajonale të AKP-së, apo të shkarkohet nga ueb-faqja: www.pak-ks.org
8. Kriteri për përzgjedhjen e ofertuesit fitues të njësive përkatëse do të jetë çmimi i ofertës më të lartë.
9. Ofertat do të pranohen me **24.12.2018** prej orës 10:00 – 12:00 në zarf të mbyllur për secilën njësi veç e veç.
10. Zarfet do të hapen publikisht në Zyrën Rajonale të Gjilanit me datë **24.12.2018** në ora 12:15
11. Ofertat përmes faksit nuk do të pranohen.
12. Sipërfaqet e prezantuara më lartë janë të përafërta dhe të dhënat më të sakta me fotot e njësive mund të merren në Zyrën Rajonale të AKP-së në Gjilan.
13. Të dhënat e detajuara për pronat lëndë e ofertës mund të merren në Zyrën e AKP-së në Gjilan, Rruga e Industrisë pn, Gjilan; në telefonin: ++381 280 310 444 apo në email adresën: info@pak-ks.org
14. Kjo shpallje përpos që do të publikohet në gazeta ditore në gjuhën shqipe dhe serbe në Kosovë do të publikohet edhe në ueb faqen zyrtare të AKP-së.
15. Në çmimin e ofertës totale duhet të përfshihen të gjitha tatimet e aplikueshme në Kosovë, përfshirë edhe TVSH 18%, etj.)

Pagesa e Qiramarrjes:

Ofertuesit fitues është i obliguar që të paguaj shumat me pagesa të rregullta paraprake mujore, duke filluar me pagesën e parë të caktuar në fillimin e kësaj Kontrate të Qirasë, dhe, deri në masën që është e zbatueshme, me pagesa mujore në vijim, të caktuara në të njëjtën ditë të muajit vijues, (apo më herët në rast se data e pagesës së parë apo ndonjë pagesë tjetër mujore ratis të jetë ndonjë festë publike.

Ofertuesit fitues për toka bujqësore pagesën e qiramarrjes duhet të bëjnë pagesë totale brenda afatit pesë ditë pune pas marrjes së kontratës për tokën që është subjekt i qiradhënies.

Dispozita të përgjithshme:

Pronat e këtyre njësive të paraqitura më lartë ofrohen për dhënie me qira "ashtu siç janë" dhe "ku janë". Ofertuesit kanë përgjegjësinë të verifikojnë përshkrimin dhe kushtet e njësive/lokaleve (gjendjen faktike) dhe AKP respektivisht Autoriteti i Likuidimit i NSH-ve përkatëse do të konsiderojë se ofertuesit kanë dijeni të mjaftueshme në lidhje me pronat e ofruara për qiradhënie dhe nuk do të jenë përgjegjës për ndonjë pengim të posedimit/shfrytëzimit eventual.

Ofertuesit me ndalesë ofertimi:

- Personat fizik apo juridik të cilët kanë uzurpuar paluajtshmërinë në pronësi shoqërore, ndaj të cilëve Agjencia apo NSH -ja ka iniciuar procedurë gjyqësore për lirimin e pronës dhe kompensimin e dëmeve eventuale;
- Personat fizik dhe juridik që: (i) nuk i kanë respektuar kushtet e ndonjë kontrate të lidhur me Agjencinë ose me çfarëdo ndërmarrje që administrohet nga Agjencia (ekzistenca dhe natyra e atij mosrespektimi do të përcaktohet nga Agjencia sipas zgjedhjes së saj), (ii) kanë borxh ose gjobë të pashlyer ndaj Agjencisë ose ndonjë ndërmarrje që administrohet nga Agjencia, (iii) personat fizik ose juridik të cilët nuk kanë paguar gjobat e caktuara nga Agjencia ose që i nënshtrohen ndonjë kërkesëpadie ose kontesti (pa marrë parasysh nëse çështja e tillë është ngritur në gjykatë apo tjetërkund).

Ofertat do të pranohen me 24.12.2018 prej orës 10:00 – 12:00 në zarf të mbyllur për secilën njësi veç e veç në:

Zyra Rajonale e AKP-së në Gjilan
Adresa: Rr. E Industrisë pn (f-ika baterive IBG), 60000 Gjilan
Tel: 0280/310-444
email: info@pak-ks.org; www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

OBAVEŠTENJE JAVNI OGLAS ZA ZAKUP

Jedinica br.	Naziv društvenog preduzeća	Naziv imovine	Lokacija imovine (Adresa)	Površina m ²
Jedinica 1	KB Prekocvi	Hangar u Prekocve	Katastarska zona Prekocv – Novo Brdo	512 m ²
Jedinica 2	NBIQ "Agromorava"	Poljoprivredno zemljište	Katastarska zona Drobesh - Viti, parcela 56/0	536 m ²
Jedinica 3	NBIQ "Agromorava"	Poljoprivredno zemljište	Katastarska zona Viti, parcela 2484/1	77291 m ²
Jedinica 4	NHNI "Morava e Binçës"	Poljoprivredno zemljište	Katastarska zona Stanišor – Novo Brdo, parcela 1152/0	7516 m ²
Jedinica 5	MZT "Fam"	Radni objekat (oprema i arhiva ostaju u preduzeću)	Katastarska zona Viti	2500 m ²
Jedinica 6	NSH "Qëndresa"	Lokal u Kamenici	Katastarska zona Kamenica	260 m ²

Opšti uslovi:

1. Period zakupa je za 1 godinu sa mogućnošću produženja a takođe i prestanak zbog privatizacije.
2. Ponude se mogu podneti individualno za svaku jedinicu pojedinačno.
3. Ponude se moraju predati lično ili u slučaju predaje u ime zakupca, stranka mora imati ovlašćenje potvrđeno kod notara.
4. Ponude treba dostaviti u zapečaćenoj kovrti (jedna kovrta – jedna ponuda za jednu jedinicu), dostaviti Regionalnoj kancelariji u Gnjilanu.
5. Na kovrti (spolja) treba navesti: br Jedinice, naziv DP-a, naziv imovine i lokaciju imovine.
6. U slučaju zakupa u vrednosti preko € 1.000 mesečno, pre potpisivanja ugovora će se tražiti od pobjedničkog ponuđača da dostavi bankarsku garanciju (ne bankarsku obveznicu) u visini ugovora.
7. Za dostavljanje ponude treba da se koristi **Obrazac za dostavljanje ponude** koji se može dobiti u Regionalnoj kancelariji KAP-a, ili preuzeti sa veb stranice: www.pak-ks.org
8. Kriterijum za izbor pobjedničkog ponuđača za dotične jedinice biće ponuda sa najvećim iznosom.
9. Ponude će biti primljene **24.12.2018** od 10:00 – 12:00 časova u zapečaćenoj kovrti za svaku jedinicu pojedinačno.
10. Kovrte će se javno otvoriti u Regionalnoj kancelariji u Gnjilanu **24.12.2018** u 12:15.
11. Ponude putem faksa neće biti prihvaćene.
12. Gore navedene površine su približne i tačniji podaci sa slikama jedinica mogu se dobiti u Regionalnoj kancelariji KAP-a u Gnjilanu.
13. Detaljni podaci o imovini koja je predmet ponude mogu se dobiti u Kancelariji KAP-a u Gnjilanu, Ulica Industrijska bb, Gnjilanu; na telefon: ++381 280 310 444 ili imejl adresu: info@pak-ks.org.
14. Ovaj oglas osim što će biti objavljen u dnevnom novinama na albanskom i srpskom jeziku na Kosovu biće objavljen i na zvaničnoj veb stranici KAP-a.
15. U cenu ukupne ponude treba uključiti sve primenljive poreze na Kosovu, uključujući i PDV 18%, itd

Plaćanje zakupnine:

Pobednički ponuđač je dužan da unapred uplaćuje redovne mesečne iznose, počevši sa prvom uplatom koja je predviđena na početku ovog Ugovora o zakupu, i do mere koliko je sprovodljivo, mesečne naknadne uplate, koje su određene za isti dan narednog meseca (ili ranije ukoliko datum prve uplate ili bilo koje druge mesečne uplate pada na određeni zvanični praznik).

Pobednički ponuđač za poljoprivredno zemljište treba platiti ukupni iznos zakupa unutar pet radnih dana posle prijema ugovora za zemljište koje je predmet zakupa.

Opšte odredbe:

Imovina gore navedenih jedinica nude se u zakup „u stanju u kakvom jesu“ i „gde su“. Odgovornost je ponuđača da ispitaju opis i uslove jedinica/lokala (činjenično stanje) i KAP odnosno Likvidacioni organ dotičnih DP-a će smatrati da su ponuđači dovoljno upoznati sa imovinama ponuđenim u zakup i neće biti odgovorni za bilo kakvo eventualno ometanje u posedu/korišćenju.

Ponuđači sa zabranom nadmetanja:

- Fizička ili pravna lica koja su uzurpirala nepokretnu imovinu u društvenom vlasništvu, prema kojima je Agjencia ili DP pokrenulo sudski postupak za oslobađanje imovine i naknadu eventualnih šteta;
- Fizička i pravna lica koja: (i) nisu poštovala uslove bilo kakvog ugovora zaključenog sa Agjencijom ili sa bilo kojim preduzećem kojim upravlja Agjencia (postojanje i prirodu takvog kršenja određuje Agjencia po sopstvenom naodenu), (ii) imaju dug ili neplaćenu novčanu kaznu prema Agjenciji ili prema određenom preduzeću kojim upravlja Agjencia, (iii) fizička ili pravna lica koja nisu platila novčane kazne određene od strane Agjencije ili koja su predmet bilo kog tužbenog zahteva ili spora (bez obzira da li je to pitanje podneto u sudu ili na nekom drugom mestu);

Ponude će biti primljene 24.12.2018 od 10:00 – 12:00 u zapečaćenoj kovrti za svaku jedinicu pojedinačno u:

Regionalna kancelarija KAP-a u Gnjilanu
Adresa: Ul. Industrijska bb (fabrika baterija IBG), 60000 Gnjilane
Tel: 0280/310-444
email: info@pak-ks.org; www.pak-ks.org



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

ZYRA E KRYEMINISTRIT SHPALL të lirë këtë vend të punës:

1. ZYRA PËR PUBLIKIMIN E GAZETËS ZYRTARE

Një(1) Zyrtar i lartë për përkthim (shqip-turqisht)
Numri i referencës: ZKM-GZK-006
Koeficienti: 8

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të zyrës për publikimin e gazetës zyrtare kryen detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

- Bënë përkthimin e të gjitha akteve juridike, dokumenteve dhe shkresave të ndryshme që publikohen nga Zyra për Publikim, nga gjuha shqipe në gjuhën turke dhe anasjelltas;
- Bënë lekturimin e të gjitha akteve juridike, dokumenteve dhe shkresave të ndryshme që dalin nga Zyra për Publikim, nga gjuha shqipe në gjuhën turke dhe anasjelltas;
- Në rast nevojë përkthen si simultane për nevoja të zyrës për publikim dhe ZKM-së dhe interpretojnë tekstet e shkruara nga gjuha shqipe në atë turke dhe anasjelltas;
- Bënë përkthimin e dokumenteve dhe shkresave të ndryshme që janë në kompetencë të Zyrës për Publikim, sidomos të teksteve juridike, korrespondencën e shkruar nga gjuha shqipe në atë turke dhe anasjelltas;
- Sipas kërkesës të Drejtorit përgatitë planin e vet vjetor të punës;
- Përgatitë raporte javore, mujore dhe vjetore për punën e vet të kryer;
- Kryen edhe punë tjera për ZPGZ që i caktohen nga Drejtori i Zyrës.

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Fakulteti i gjuhës dhe leterisë shqipe, turke ;
- Tri (3) vite përvojë pune profesionale në lekturim, përkthim.
- Kerkolet njohja e gjuhës turke (në të folur dhe shkruar);
- Njohës i mirë i gjuhës shqipe dhe /ose serbe. Njohja e gjuhëve të tjera si anglishtja etj është përparësi.
- Të jetë në gjendje të perkthej simulant nga gjuha shqipe-turke dhe anasjelltas.
- Shkathësitë kompjuterike, përfshirë njohuritë Windows , Outlook, Microsoft Works/Office, Excel, Internet dhe të krijimit të prezantimeve.
- Aftësi në të shkruar.
- Të jetë energjik, të ketë shkathtësi të mira ndër njerëzore dhe të jetë i/e gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës dhe trysni kohe.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Zyra e Kryeministrit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëprerë aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuar nga MASHT-i), dëshminë e përvojës së punës, dy referenca.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (rruga Nëna Tereze p.n.). Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen : <http://www.kryeministri-ks.net/>; <http://www.kryeministri-ks.net/zck/>.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në Divizionin e burimeve njerëzore, Ndërtesa e Qeverisë, kati i IV, zyra nr. 406.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatet e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Kohëzgjatja e emërimit sipas LSHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese një (1) vjeçare.

Afati i konkurrimit është prej datës: 17 /12 / 2018 deri me datë 31/12/2018, deri në orën 16:00.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 14 818 dhe 038 200 14 817.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Kancelarija Premijera-Office of the Prime Minister

KANCELARIJA PREMIJERA objavljuje slobodnim sledeće radno mesto:

KANCELARIJA ZA OBJAVLJIVANJE SLUŽBENOG LISTA

Jedan (1) Visoki službenik za prevodenje (albanski -turski)
Referentni broj: KP- SLK-006
Koeficijent : 8

Dužnosti i odgovornosti: Pod nadzorom direktora Kancelarije za objavljivanje Službenog lista obavlja sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Obavlja prevodenje svih pravnih akata, raznih dokumenata i dopisa koji se objavljuju od strane Kancelarije za objavljivanje sa albanskog na turski jezik i obrnuto;
- Obavlja lekturu svih pravnih akata, raznih dokumenata i dopisa koje proističu iz Kancelarije za objavljivanje sa albanskog na turski jezik i obrnuto;
- Ako je potrebno, vrši simultane prevode za potrebe kancelarije za objavljivanje i KP i tumači pisane tekstove sa albanskog na turski jezik i obrnuto;
- Vrši prevod dokumenata i raznih dopisa koji su u nadležnosti Kancelarije za objavljivanje, posebno pravne tekstove, pisane korespondenciju od albanskog na turski i obrnuto;
- Na zahtev direktora priprema svoj godišnji plan rada;
- Priprema nedeljne, mesečne i godišnje izveštaje o svom radu ;
- Obavlja i druge poslove po nalogu direktora KOSL.

Kvalifikacije, radno iskustvo i veštine:

- Fakultet za albanski , turski jezik i književnost;
- Tri (3) godine stručnog radnog iskustva u oblasti lekture i prevodenja
- Potrebno znanje turskog jezika (govornog i pisanog);
- Dobro poznavanje albanskog i / ili srpskog jezika. Znanje drugih jezika kao što su engleski, itd je prednost.
- Treba da je u stanju da simultano prevodi sa albanskog na turski i obrnuto.
- Poznavanje rada na kompjuteru, uključujući poznavanje Windows, Outlook, Microsoft Works / Office, Excel, Internet i stvaranje prezentacija
- Veštine pisanja.
- Treba biti energičan, da ima sposobnost izgradnje dobrih međuljudskih odnosa i da bude / spreman da radi sa fleksibilnim sati rada i pod pritiskom vremena.

OSNOVNI PODACI ZA KANDIDATE O PROCEDURAMA KONKURISA

Kancelarija Premijera pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja aplikacije od strane svih zajednica na Kosovu.

Ne-većinske zajednice imaju pravo na fer i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe kao što je navedeno u članu 11. stav 3 Zakon br. 03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo.

Uz aplikaciju se treba priložiti sledeća propratna dokumentacija: popunjeni obrazac za aplikaciju, dokaz o obrazovnim i stručnim kvalifikacijama (diplome stečene u inostranstvu moraju biti verifikovane od strane MONT-a) , dokaz radnog iskustva, dve reference .

Zahtev za zapošljavanje i opis radnog mesta se može dobiti na recepciji zgrade Vlade Republike Kosovo (ul. Majke Tereze bb). Zvanični obrazac za aplikaciju, možete naći i na web stranici: <http://www.rks-gov.net/pm/> ; <http://www.kryeministri-ks.net/zck/>.

Dokumentacija mora biti dostavljena Kancelariji za ljudske resurse, zgrada Vlade, IV sprat, kancelarija br. 406. Korišćenje pogrešnog obrazca i nepotpunog sa podacima koji su potrebni, će se smatrati nevažećim.

Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo kandidati koji su ušli u uži izbor će biti kontaktirani.

Kandidati koji su izabrani u uži izbor će proći kroz pismeni ispit i intervju.

Trajanje imenovanja prema ZSL, uključujući i period probnog rada je godinu dana.

Rok za konkurisanje je od dana 17/12/2018 do dana 31/12/2018, do 16:00.

Prijave pristigle nakon poslednjeg roka konkursa neće biti prihvaćene.

Za dodatne informacije, pozovite brojevi: 038 200 14 818 i 038 200 14 817



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
 Zyra e Kryeministrit-Kancelarija Premijera-Office of the Prime Minister

ZYRA E KRYEMINISTRIT shpall të lirë këtë vend të punës:

I. Një (1) Asistent Administrativ
 Numri i referencës: ZKM-SP-010
 Koeficienti: 6

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e sekretarit të përgjithshëm kryen detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

1. Ofron mbështetje të shumëllojshme administrative dhe teknike përfshirë telefonatat, skanimin, kopjimin e dokumenteve, pritjen e palëve;
2. Pranon dhe shpërndan korrespondencën, shkresat dhe dokumentet e cila i drejtohet zyrës së sekretarit të përgjithshëm si dhe kujdeset për mirëmbajtjen e saj;
3. Siguron përkrahje administrative dhe teknike si dhe fotokopjon dokumente për nevojat zyrës dhe bënë shpërndarjen në zyrat tjera përkatëse të institucionit.
4. Sipas kërkesës kryen shërbimin e vozitjes të sekretarit të përgjithshëm si dhe mban evidencën e të gjitha udhëtimeve, shënon kilometrazhin ditore si dhe shpenzimin e lëndëve djegëse;
5. Nëse kërkohet nga udhëhoqësi ndihmon në shpërndarjen e postës.
6. Kryen edhe detyra tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë e shkollës së mesme.
- Së paku tri (3) vite përvojë pune në fushën përkatëse administrative –teknike.
- Patentë shofer të vlefshëm.
- Njohja e gjuhës shqipe dhe /ose serbe.
- Shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Internet etj);
- Të jetë në gjendje të punojë nën presion, të ketë etikë në punë dhe integritet të lartë punë.
- Të jetë në gjendje të punojë me orar fleksibil të punës.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURRIMIT

Zyra e Kryeministrit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil, siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet përcjellëse, si vijojnë: Formulari i plotësuar i aplikimit, dëshmia për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), dëshmia e përvojës së punës dhe dy referenca.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (rruga Nëna Terezë p.n.). Formularin zyrtar për aplikim mund ta gjeni edhe në Web faqen : <http://www.kryeministri-ks.net/>; <http://www.kryeministri-ks.net/zck/>.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në Divizionin e burimeve njerëzore, Ndërtesa e Qeverisë, kati IV, zyra nr. 406.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

